



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 22 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRYEZA E LËNDËS

I.	HISTORIKU PROCEDURAL.....	2
II.	PARASHTRIMET E PALËVE.....	5
	A. Kundërshtimet e Mbrojtjes së Veselit.....	5
	B. Kundërshtimet e Mbrojtjes së Thaçit, Mbrojtjes së Selimit dhe Mbrojtjes së Krasniqit.....	6
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE.....	8
	A. Mocionet paraprake.....	8
	B. Burimet e së drejtës dhe normat e interpretimit.....	8
	C. Aktakuza.....	9
IV.	DISKUTIM.....	9
	A. Standardet e përgjithshme lidhur me formën e Aktakuzës së Konfirmuar.....	9
	B. Kundërshtimet ndaj Vendimit të Konfirmimit dhe zbatueshmëria e KPPK-së për formën e aktakuzës.....	17
	C. Argumentimi i NKP-së.....	24
	D. Argumentimi i ndihmës dhe inkurajimit.....	47
	E. Argumentimi i përgjegjësisë eprore.....	49
	F. Kundërshtime ndaj paraqitjes së krimeve të veçanta në aktakuzë.....	55
	G. Përfundim.....	82
	H. Zgjatja e afatit për lejen për apelim.....	82
V.	VENDIM.....	83

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 9(5)(a) dhe 97(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZSP”) dorëzoi për konfirmim një aktakuzë konfidenciale dhe *ex parte* kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (“z. Thaçi”, “z. Veseli”, “z. Selimi” dhe “z. Krasniqi”, bashkërisht “të akuzuarit”) së bashku me material provues në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.²

2. Më 2 korrik 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi ZPS-në të dorëzonte një aktakuzë të rishikuar e cila të përfshinte një paraqitje të hollësishme të fakteve, ku të përvijoheshin me më shumë konkretësi akuzat faktike që i korrespondojnë secilit krim të përfshirë në akuzë.³

3. Më 24 korrik 2020, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e rishikuar për konfirmim (“Aktakuza e Rishikuar”).⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim*, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 13, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versione të redaktuara publike të parashtrimit të protokolluar kryesor dhe të Shtojcës 1 u protokolluan më 18 nëntor 2020, F00002/RED dhe F00002/RED/A01.

³ KSC-BC-2020-06, F00010, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me Rregullën 86(4) të Rregullores* (“Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4)”), 2 korrik 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00011, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për Konfirmim*, 24 korrik 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versione të redaktuara publike të parashtrimit të protokolluar kryesor dhe të Shtojcës 1 u protokolluan më 18 nëntor 2020, F00011/RED dhe F00011/RED/A01.

4. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën e Rishikuar (“Vendimi i Konfirmimit”).⁵
5. Më 30 tetor 2020, ZPS-ja paraqiti aktakuzën sipas konfirmimit (“Aktakuza e Konfirmuar”),⁶ me redaktimet e autorizuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁷
6. Më 12 mars 2021, Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi mocionin paraprak sipas rregullës 97(1)(b) të Rregullores, në të cilin ngrinte pretendime për mangësi në formën e Aktakuzës e Konfirmuar (“Mocioni Paraprak i Thaçit”).⁸
7. Më 15 mars 2021, Mbrojtja e z. Veseli (“Mbrojtja e Veselit”),⁹ e z. Selimi (“Mbrojtja e Selimit”)¹⁰ dhe e z. Krasniqi (“Mbrojtja e Krasniqit”)¹¹ dorëzuan mocionet paraprake përkatëse ku ngrenë kundërshtime ndaj Aktakuzës së Konfirmuar (përkatësisht, “Mocioni Paraprak i Veselit”, “Mocioni Paraprak i Selimit” dhe “Mocioni Paraprak i Krasniqit”).
8. Më 25 mars 2021, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një përgjigje ndaj mocioneve paraprake të dorëzuara nga Mbrojtja e tre të akuzuarve të tjerë, ku parashtrohte

⁵ KSC-BC-2020-06, F00026/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, konfidencial. Një version i redaktuar publik u protokollua më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale. Një version i korrigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar, në të cilin u korrigjuan disa gabime shtypi u dorëzua më 4 nëntor 2020, si version rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00045/A01), version konfidencial i redaktuar (F00045/A02) dhe version i redaktuar publik (F00045/A03). Një version me më pak redakte i F00045/A02 u dorëzua më 11 dhjetor 2021, F00134, konfidencial.

⁷ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(c)-(d).

⁸ KSC-BC-2020-06, F00215, Mbrojtja e Thaçit, *Mocion që Pretendon Mangësi në Aktakuzën kundër z. Hashim Thaçi*, 12 mars 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën datë, F00215/RED.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00225, Mbrojtja e Veselit, *Mocion Paraprak i Kadri Veselit për Kundërshtimin e Aktakuzës*, 15 mars 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u protokollua më 18 mars 2021, F00225/RED2.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00222, Mbrojtja e Selimit, *Kundërshtimi i Formës së Aktakuzës nga Mbrojtja e Selimit*, 15 mars 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u protokollua më 11 maj 2021, F00222/RED,

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00221, Mbrojtja e Krasniqit, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Krasniqit që Pretendon Mangësi në Aktakuzë*, 15 mars 2021, publik.

se i mbështet parashtrimet e tyre për aq sa nuk bien ndesh apo nuk cenojnë pozicionin e mbajtur në Mocionin Paraparak të Thaçit.¹²

9. Më 23 prill 2021, në përputhje me afatin e vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹³ ZPS-ja dorëzoi: (i) një përgjigje përmbledhëse ndaj mocioneve paraprake të parashtruara nga Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Krasniqit (“Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së”);¹⁴ dhe (ii) një përgjigje ndaj mocionit paraprak të parashtruar nga Mbrojtja e Veselit (“Përgjigjja Shtesë e ZPS-së”).¹⁵

10. Më 14 dhe 17 maj 2021, në përputhje me afatet përkatëse të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹⁶ Mbrojtja e Thaçit,¹⁷ Mbrojtja e Selimit¹⁸ dhe Mbrojtja e Krasniqit¹⁹ iu kundërpërgjigjën Përgjigjes Përmbledhëse të ZPS-së dhe Mbrojtja e Veselit iu kundërpërgjigj Përgjigjes Shtesë të ZPS-së.²⁰

11. Më 19 maj 2021 dhe 24 qershor 2021, përkatësisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi afatin për marrjen e vendimit mbi mocionet paraprake të

¹² KSC-BC-2020-06, F00238, Mbrojtja e Thaçit, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Mocioneve Paraprake të Parashtruara nga Ekipet e Mbrojtjes të Veselit, Selimit dhe Krasniqit*, 25 mars 2021, publik.

¹³ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 24 mars 2021 (“Transkripti i datës 24 mars 2021”), publik, f. 391, rreshtat 11-18.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00258, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake të THAÇIT, SELIMIT dhe KRASNIQIT në lidhje me Formën e Aktakuzës*, 23 prill 2021, publike.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00261, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit Paraprak të VESELIT për Kundërshtim të Aktakuzës*, 23 prill 2021, publike.

¹⁶ Transkripti i datës 24 mars 2021, f. 391, rreshtat 11-18; KSC-BC-2020-06, F00296, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Afatit*, 14 maj 2021, publik.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, F00303, Mbrojtja e Thaçit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj “Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë për Mocionet Paraprake të THAÇIT, SELIMIT dhe KRASNIQIT në lidhje me Formën e Aktakuzës” (“Kundërpërgjigjja e Thaçit”)*, 14 maj 2021, publike.

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00297, Mbrojtja e Selimit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me Kundërshtimin e Mbrojtjes për Formën e Aktakuzës (“Kundërpërgjigjja e Selimit”)*, 14 maj 2021, publike.

¹⁹ KSC-BC-2020-06, F00298, Mbrojtja e Krasniqit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë për Mocionet Paraprake të Thaçit, Selimit dhe Krasniqit në lidhje me Formën e Aktakuzës (“Kundërpërgjigjja e Krasniqit”)*, 14 maj 2021, publike.

²⁰ KSC-BC-2020-06, F00309, Mbrojtja e Veselit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Mocionin Paraprak për Kundërshtimin e Aktakuzës (“Kundërpërgjigjja e Veselit”)*, 17 maj 2021, publike.

paraqitura në këtë çështje dhe bëri të ditur se vendimet për to do të dilnin ditën e enjte, më 22 korrik 2021.²¹

II. PARASHTRIMET E PALËVE

A. KUNDËRSHTIMET E MBROJTJES SË VESELIT

12. Mbrojtja e Veselit parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë gabime faktike dhe ligjore gjatë përcaktimit të kriterëve kontekstuale për krimet e luftës²² dhe ka bërë konstatime të gabuara lidhur me shtrirjen gjeografike të Aktakuzës së Konfirmuar.²³ Rrjedhimisht, ajo kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake t'i rishikojë në përputhje me këtë konstatimet e tij në Vendimin e Konfirmimit dhe t'i japë urdhër ZPS-së: (i) ta ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar për të përjashtuar pretendimet e lidhura me incidente të krimeve të luftës që pretendohet se kanë ndodhur përpara mesit të vitit 1999 ose pas 10 qershorit 1999; dhe (ii) ta ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar dhe t'i heqë pretendimet për krime lufte në lidhje me incidente që pretendohet se kanë ndodhur në Shqipëri.²⁴

13. ZPS-ja përgjigjet se Mocioni Paraprak i Veselit nuk identifikon asnjë mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar sipas rregullës 97(1)(b) të Rregullores dhe duhet të hidhet poshtë menjëherë sepse del jashtë kuadrit të mocioneve paraprake të lejueshme sipas rregullës së lartpërmendur.²⁵

14. Mbrojtja e Veselit kundërpërgjigjet se Përgjigjja shtesë e ZPS-së është një orvatje për të fshehur paaftësinë e ZPS-së për t'u dhënë përgjigje problemeve materiale që ajo

²¹ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 19 maj 2021, publik, f. 451, rreshtat 15-17; F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 24 qershor 2020, publik, para. 15, 16(f).

²² Mocioni Paraprak i Veselit, para. 4-74.

²³ Mocioni Paraprak i Veselit, para. 75-87.

²⁴ Mocioni Paraprak i Veselit, para. 88(b)-(d).

²⁵ Përgjigjja Shtesë e ZPS-së, para. 1-5, 7-8 dhe referencat aty.

ngre dhe për ta ngushtuar në mënyrë të palejueshme fushëveprimin e rregullës 97(1)(b) të Rregullores dhe të nenit 39(1) të Ligjit.²⁶

B. KUNDËRSHTIMET E MBROJTJES SË THAÇIT, MBROJTJES SË SELIMIT DHE MBROJTJES SË KRASNIQIT

15. Mbrojtja e Thaçit parashtron se Aktakuza e Konfirmuar është e mangët për shkak të mungesës së konkretësisë dhe për shkak të gabimeve të konsiderueshme në argumentim.²⁷ Ajo kërkon t'i jepet urdhër ZPS-së: (i) të japë hollësi më konkrete për sjelljen që pretendon se ka bërë z. Thaçi dhe, nëse nuk e bën këtë, t'i jepet urdhër ZPS-së të zvogëlojë, ngushtojë ose eliminojë akuzat që kanë këto mangësi; dhe (ii) të eliminojë akuzat me mangësi të tjera.²⁸

16. Mbrojtja e Selimit parashtron se Aktakuza e Konfirmuar është e mangët sepse nuk përmban hollësi të mjaftueshme në lidhje me faktet materiale që lidhen me provat kundër z. Selimi.²⁹ Ajo miraton dhe mbështet edhe kundërshtimet e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me krime të veçanta të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.³⁰ Mbrojtja e Selimit kërkon që ZPS-së t'i jepet urdhër ta ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar në bazë të kundërshtimeve të paraqitura në mocionin e saj paraprak, për të bërë paraqitje më konkrete të pretendimeve kundër z. Selimi.³¹

17. Mbrojtja e Krasniqit kundërshton: (i) argumentimin (disa elementeve të caktuara të) ndërmarrjes kriminale të përbashkët ("NKP") dhe të përgjegjësisë komanduese; (ii) mospërcaktimin konkretisht, siç pretendohet, të veprimeve të veçanta apo të praktikës së veprimit që pretendohet se ka bërë ose nuk ka bërë vetë z. Krasniqi, të

²⁶ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 1-2, 14-15.

²⁷ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 1.

²⁸ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 1, 63.

²⁹ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 1, 78.

³⁰ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 28.

³¹ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 79(b).

cilat justifikojnë format e pretenduara të përgjegjësive; (iii) paraqitjen e akuzave të përndjekjes dhe zhdukjes me forcë; dhe (iv) përdorimin e termave të tillë shumëpërfshirës si “përfshirë”, “duke përfshirë”, “ndër të cilët”, “ndër të cilat” ose “rreth” në mbarë Aktakuzën e Konfirmuar.³² Për aq sa nuk bien ndesh me mocionin e saj paraprak, ajo miraton dhe u bashkohet mocioneve paraprake që pretendojnë mangësi në Aktakuzën e Konfirmuar të parashtruara nga ekipet e Mbrojtjes të tre të akuzuarve të tjerë.³³ Mbrojtja e Krasniqit kërkon t’i jepet urdhër ZPS-së ta ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar në mënyrë që t’u përgjigjet kundërshtimeve të ngritura prej saj.³⁴

18. ZPS-ja përgjigjet se Mocioni Paraprak i Thaçit, Mocioni Paraprak i Selimit dhe Mocioni Paraprak i Krasniqit nuk identifikojnë asnjë mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar dhe rrjedhimisht duhen rrëzuar.³⁵ Ajo parashton se, në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86(3) të Rregullores, Aktakuza e Konfirmuar jep një përshkrim të shkurtër të fakteve materiale të provave të ZPS-së dhe të krimeve dhe formave të përgjegjësive të përfshira në Aktakuzë.³⁶

19. Mbrojtja e Thaçit u kundërpërgjigjet tri problemeve që lindin nga Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së.³⁷ Mbrojtja e Selimit u kundërpërgjigjet gjashtë problemeve që lindin nga Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së.³⁸ Mbrojtja e Krasniqit u kundërpërgjigjet katër problemeve që trajtohen në Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së.³⁹

³² Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 2-3.

³³ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 4.

³⁴ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 5, 62(a)-(c).

³⁵ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 1, 47

³⁶ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 1.

³⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 2.

³⁸ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 2.

³⁹ Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 5-31.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. MOCIONET PARAPRAKE

20. Në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr vendim në lidhje me çdo mocion paraparak, përfshirë edhe kundërshtimet ndaj aktakuzës.

21. Në pajtim me rregullën 97(1)(b) të Rregullores, i akuzuari mund t'i paraqesë në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit mocione paraprake gjykatësit të procedurës paraprake, të cilat pretendojnë mangësi në formën e aktakuzës.

B. BURIMET E SË DREJTËS DHE NORMAT E INTERPRETIMIT

22. Neni 3(2) i Ligjit përcakton se Dhomat e Specializuara ("DHS") gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me:

- a. Kushtetutën e Republikës së Kosovës ("Kushtetuta");
- b. këtë ligj, si *lex specialis*;
- c. dispozitat e tjera të ligjeve të Kosovës, të përfshira shprehimisht në këtë ligj;
- d. të drejtën zakonore ndërkombëtare, së cilës i jepet përparësi kundrejt ligjeve vendase me nenin 19(2) të Kushtetutës, dhe
- e. të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilave u jepet përparësi kundrejt ligjeve vendore me nenin 22 të Kushtetutës.

23. Neni 3(4) i Ligjit parashikon më tej se çdo ligj, rregullore, rregullore dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë e Kosovës, që nuk është përfshirë shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohet për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e DHS-së dhe ZPS-së dhe se ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë kundërthënëse të çfarëdo ligji apo rregulloreje tjetër.

24. Rregulla 4(1) e Rregullores thotë se Rregullorja interpretohet në pajtim me kornizën e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit dhe, nëse është e përshtatshme, me Kodin e

Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK"). Sipas rregullës 4(3), çdo paqartësi që nuk mund të zgjidhet në përputhje me interpretimin e lartpërmendur, zgjidhet duke u bazuar në interpretimin më të favorshëm për të dyshuarin ose të akuzuarin në rrethanat konkrete.

C. AKTAKUZA

25. Në pajtim me nenin 21(4)(a) të Ligjit, i akuzuari njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që ai e kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij.

26. Në pajtim me nenin 38(4) të Ligjit dhe me rregullën 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë emrin dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe një përshkrim të shkurtër të fakteve të çështjes dhe të veprës ose veprave penale për të cilat akuzohet i dyshuari dhe në veçanti formën e përgjegjesisë penale të pretenduar në lidhje me veprat penale të akuzuara. Aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës, pra provat në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat, si dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDET E PËRGJITHSHME LIDHUR ME FORMËN E AKTAKUZËS SË KONFIRMUAR

1. Konkretësia dhe qartësia

27. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në pajtim me nenet 21(4)(a) dhe 38(4) të Ligjit, si edhe me rregullën 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë faktet në të cilat mbështeten akuzat dhe veprat penale, përfshirë format e përgjegjesisë të përfshira në aktakuzë, të paraqitura me konkretësi dhe qartësi të mjaftueshme.⁴⁰ Kjo

⁴⁰ KSC-BC-2020-07, IA004/F00007, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit për Mocionet Paraprake ("Vendimi i Apelit në "Gucati dhe Haradinaj")*, 23 qershor 2021, para. 35; KSC-BC-2020-07, F00147, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i Vendimit në lidhje me Mocionet Paraprake (Vendimi mbi Mocionin Paraprak në "Gucati dhe Haradinaj")*, 8 mars 2021, publik, para. 38; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 10.

konkretësi dhe qartësi duhet të sigurojë që Aktakuza, si dokument më vete,⁴¹ t'i japë të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartë dhe plotësisht natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij, me qëllim përgatitjen e një mbrojtjeje adekuate.⁴² Rrjedhimisht, i akuzuari nuk duhet të ketë nevojë të konsultojë dokumente të tjera për të kuptuar dhe ndërtuar tablonë tërësore të pretendimeve faktike mbi të cilat mbështeten akuzat.⁴³

28. Konstatimi nëse një fakt mbështet një akuzë të caktuar dhe, rrjedhimisht, duhet paraqitur në aktakuzë me konkretësi, nuk mund të bëhet në përgjithësi, por rast pas rasti, duke marrë parasysh ndër të tjera natyrën dhe shkallën e veprave penale të parashtruara në aktakuzë, rrethanat e çështjes, afërsinë e pretenduar të të akuzuarit me ngjarjet dhe formën e përgjegjësisë penale të parashtruar në aktakuzë.⁴⁴ Megjithatë,

⁴¹ Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 38; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 11.

⁴² Vendimi i Apelit në "Gucati dhe Haradinaj", para. 36; Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 38. *Shih edhe* Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), publik, para. 9, 11. ECtHR, *Mattoccia v. Italy*, no. 23969/94, [Judgment](#), 25 July 2000, para. 60. *Për ngjashmëri*, ICTR, *Prosecutor v. Nsengiyumva*, ICTR-96-12-I, Trial Chamber III, [Decision on the Defence Motion Raising Objections on Defects in the Form of the Indictment and to Personal Jurisdiction on the Amended Indictment](#), 12 May 2000, para. 1, f. 6; *Prosecutor v. Ntagerura et al.*, ICTR-99-46-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Ntagerura Appeal Judgment"), 7 July 2006, para. 22; ICTY, *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Kupreškić Appeal Judgment"), 23 October 2001, para. 88; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/I, Pre-Trial Judge, [Decision Relating to the Examination of the Indictment of 10 June 2011 Issued Against Mr Salim Jamil Ayyash, Mr Mustafa Badreddine, Mr Hussein Hassan Oneissi & Mr Assad Hassan Sabra](#), 28 June 2011, para. 27; ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-143-t-ENG, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Defence Request Concerning the Time Limit for the Prosecutor to File the Document Containing a Detailed Description of the Charges](#) ("Al Hassan 5 October 2018 Decision"), 5 October 2018, para. 30; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-199, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the "Prosecution's Request to Postpone the Confirmation Hearing and All Related Disclosure Deadlines"](#) ("Yekatom and Ngaïssona 15 May 2019 Decision"), 15 May 2019, para. 41-42.

⁴³ Vendimi i Apelit në "Gucati dhe Haradinaj", para. 49; Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 38; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 11.

⁴⁴ Vendimi i Apelit në "Gucati dhe Haradinaj", para. 38, 42; Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 39; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 16. *Për ngjashmëri*, ICTY, [Kupreškić Appeal Judgment](#), para. 89; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Blaškić Appeal Judgment"), 29 July 2004, para. 210; ICTR, [Ntagerura Appeal Judgment](#), para. 23; *Uwinkindi v. Prosecutor*, ICTR-01-75-AR72(C), Appeals Chamber, [Decision on Defence Appeal Against the Decision Denying Motion Alleging Defects in the Indictment](#) ("Uwinkindi 16 November 2011 Decision"), 16 nëntor 2011, para. 4-5; ICC, [Al Hassan 5 October 2018 Decision](#), para. 30; [Yekatom and Ngaïssona 15 May 2019 Decision](#), para. 41-42; *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-2359, Trial Chamber VI, [Judgment](#) ("Ntaganda Trial Judgment"), 8 July 2019, para. 38; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-

në disa raste, nuk mund të përjashtohet mundësia që disa hollësi të caktuara të çështjes, si numri dhe identiteti i viktimave,⁴⁵ të mbeten të fshehura edhe pas përfundimit të gjyqimit.⁴⁶ Gjithsesi, kur shqyrtohet nëse aktakuza i përmbush kushtet e lartpërmendura, aktakuza duhet parë në tërësi dhe paragrafë apo fraza të veçuara duhen lexuar në kuadër të të gjithë dokumentit.⁴⁷

29. Gjithashtu, duhet bërë qartë dallimi midis fakteve ku mbështeten akuzat, të cilat duhen paraqitur siç thuhet më lart, dhe provave të propozuara për t'i vërtetuar këto.⁴⁸ Nuk është nevoja që aktakuza të paraqesë provat me të cilat vërtetohen faktet ku

585, Trial Chamber V, [Decision on the Yekatom Defence Motion for Additional Details](#), 13 July 2020, para. 19; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/04-01/18-874, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr Alfred Yekatom Against the Decision of Trial Chamber V of 29 October 2020 Entitled 'Decision on Motions on the Scope of the Charges and the Scope of Evidence at Trial'](#) (“Yekatom and Ngaïssona 5 February 2021 Judgment”), 5 February 2021, para. 54.

⁴⁵ Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 39; ECtHR, *Sampech v. Italy*, no. 55546/09, [Décision](#) (“Sampech 19 May 2015 Decision”), 19 May 2015, para. 110. Për ngjashmëri, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-3121-Red, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeal of Mr Thomas Lubanga Dyilo Against His Conviction](#) (“Lubanga Appeal Judgment”), 1 December 2014, para. 123; [Al Hassan 5 October 2018 Decision](#), para. 30; [Yekatom and Ngaïssona 15 May 2019 Decision](#), para 41.

⁴⁶ Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 39; ECtHR, *Previti v. Italy*, no. 45291/06, [Judgment](#), 8 December 2009, para. 208. Për ngjashmëri, STL, *Prosecutor v. Ayyash*, STL-18-10/PT/TC, Trial Chamber II, [Decision on Alleged Defects in the Form of the Indictment](#) (“Ayyash 28 September 2020 Decision”), 28 September 2020, para. 54(b).

⁴⁷ Vendimi i Apelit në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 56; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 39. Për ngjashmëri, ICTR, *Rutaganda v. Prosecutor*, ICTR-96-3-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 26 May 2003, para. 304; *Gacumbitsi v. Prosecutor*, ICTR-2001-64-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 7 July 2006, para. 123; *Prosecutor v. Seromba*, ICTR-2001-66-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 12 March 2008, para. 27; ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (“Prlić et al. Appeal Judgment”), 29 November 2017, para. 27; STL, [Ayyash 28 September 2020 Decision](#), para. 14(e); ICC, [Yekatom and Ngaïssona 5 February 2021 Judgment](#), para. 54.

⁴⁸ Vendimi i Apelit në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 38; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 40. Për ngjashmëri, ICTY, *Prosecutor v. Furundžija*, IT-95-17/1-A, Appeals Chamber, [Judgment](#) (“Furundžija Appeal Judgment”), 21 July 2000, para. 153; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 210; ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-2205, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeals of Mr Lubanga Dyilo and the Prosecutor Against the Decision of Trial Chamber I of 14 July 2009 Entitled 'Decision Giving Notice to the Parties and Participants that the Legal Characterisation of the Facts May Be Subject to Change in Accordance with Regulation 55\(2\) of the Regulations of the Court'](#), 8 December 2009, poshtëshënimi 163.

mbështeten akuzat.⁴⁹ Këto prova do të nxirren në bazë të dispozitave përkatëse. Çdo mosmarrëveshje lidhur me pikat faktike vendoset në fazën e gjykimit dhe jo përmes mocioneve paraprake mbi formën e aktakuzës.⁵⁰ Gjithsesi, kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara siguron se, krahas procesit të nxjerrjes, të akuzuarit i vihen në dispozicion në një fazë të hershme edhe hollësi të tjera provuese në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b), në Vendimin e Konfirmimit dhe në parashtrimet e bëra në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores.⁵¹

30. Së fundi, kundërshtimet lidhur me elementet juridike të një veprë penale apo të një forme përgjegjësie penale nuk përbëjnë kundërshtime ndaj formës së aktakuzës, por janë çështje që trajtohen në fazën e gjykimit.⁵²

2. Hollësitë

31. Kur pretendohet se i akuzuari i ka kryer personalisht veprimet ku mbështeten veprat penale të përfshira në aktakuzë, është e nevojshme të jepen, aq sa është e mundur dhe me “saktësinë më të madhe”:⁵³ identiteti i viktimës (viktimave); vendi

⁴⁹ Vendimi i Apelit në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 38; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 40. *Për ngjashmëri*, ICTY, [Furundžija Appeal Judgment](#), para. 147; [Kupreškić Appeal Judgment](#), para. 88; [Prlić et al. Appeal Judgment](#), para. 27.

⁵⁰ Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 40. *Për ngjashmëri*, ICTY, *Prosecutor v. Kunarac*, IT-96-23, Trial Chamber, [Decision on the Form of Indictment](#), 4 November 1999, para. 13; *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39, Trial Chamber, [Decision Concerning Preliminary Motion on the Form of the Indictment](#), 1 August 2000, para. 8; STL, [Ayyash 28 September 2020 Decision](#), para. 14(o). *Shih edhe* ECtHR, [Sampech 19 May 2015 Decision](#), para. 110.

⁵¹ *Shih* rregullat 86(3), (5) dhe 95(4) të Rregullores; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 40. *Për ngjashmëri, shih* ICC, [Lubanga Appeal Judgment](#), para. 124; [Ntaganda Trial Judgment](#), para. 37.

⁵² *Për ngjashmëri*, ICTY, *Prosecutor v. Šainović et al.*, IT-05-87-PT, Trial Chamber III, [Decision on Ojdanić’s Motion Challenging Jurisdiction: Indirect Co-Perpetration](#), 22 March 2006, para. 23; *Prosecutor v. Mucić et al.*, IT-96-21, Appeals Chamber, [Decision on Application for Leave to Appeal by Hazim Delic \(Defects in the Form of the Indictment\)](#), 6 December 1996, f. 8.

⁵³ Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 17. *Për ngjashmëri*, ICTY, *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25, Trial Chamber, [Decision on Preliminary Motion on Form of Amended Indictment \(“Krnojelac 11 February 2000 Decision”\)](#) 11 February 2000, para. 18; [Blaskić Appeal Judgment](#), para. 213. *Shih edhe* SCSL, *Prosecutor v. Brima et al. (AFRC case) (“Brima et al. Appeal Judgment”)*, SCSL-2004-16-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 22 February 2008, para. 38.

dhe data e përafërt e veprimeve të pretenduara; mënyra dhe mjetet me anë të të cilave janë kryer dhe elementi mendor i lidhur me to.⁵⁴

32. Nga ana tjetër, kur nuk pretendohet se i akuzuari e ka kryer drejtpërdrejt krimin ose kur, për nga natyra, krimet bëhen kundër një grupi apo një bashkësie njerëzish, të akuzuarit duhet t'i jepet sa më shumë informacion i hollësishëm në lidhje me: vendet, kohën dhe numrin e përafërt të viktimave; hollësitë e nevojshme për të kuptuar elementët e krimeve, si sjellja e pretenduar e të akuzuarve që u bë shkas për përgjegjësinë penale të tyre, përfshirë konturet e planit ose qëllimit të përbashkët, zbatimin e tij, si edhe kontributin e të akuzuarve në të; elementin mendor të lidhur me të; dhe identitetet e bashkëkryesve të pretenduar ose anëtarëve të NKP-së, nëse ka dhe në goftë se dihen.⁵⁵

33. Sa i takon datës kur pretendohet se është kryer krimi, nëse nuk mund të jepet një datë precize, mund të jepet një periudhë e arsyeshme datash.⁵⁶

⁵⁴ Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 17. *Për ngjashmëri*, ICTY, [Blaskić Appeal Judgment](#), para. 213; ICC, [Lubanga Appeal Judgment](#), para. 122-123; [Al Hassan 5 October 2018 Decision](#), para. 30; [Yekatom and Ngaïssona 15 May 2019 Decision](#), para. 41-42.

⁵⁵ Vendimi i Apelit në "Gucati dhe Haradinaj", para. 45; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 41; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 18. *Për ngjashmëri*, ICC, [Al Hassan 5 October 2018 Decision](#), para. 30; [Yekatom and Ngaïssona 15 May 2019 Decision](#), para. 41-42; [Lubanga Appeal Judgment](#), para. 123. *Shih* Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 17. *Për ngjashmëri*, ICTY, [Krnojelac 11 February 2000 Decision](#), para. 18; [Blaskić Appeal Judgment](#), para. 213; SCSL, [Brima et al. Appeal Judgment](#), para. 38; ICTR, *Bagosora et al. v. Prosecutor*, ICTR-98-41-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 14 December 2011, para. 132; ICC, [Lubanga Appeal Judgment](#), para. 122-123; [Al Hassan 5 October 2018 Decision](#), para. 30; [Yekatom and Ngaïssona 15 May 2019 Decision](#), para. 41-42.

⁵⁶ *Për ngjashmëri*, STL, [Ayyash 28 September 2020 Decision](#), para. 14(j); ICTR, *Prosecutor v. Ntawukuriryayo*, ICTR-05-82-PT, Trial Chamber III, [Decision on defence preliminary motion alleging defects in the indictment](#), 28 April 2009, para. 15; *Prosecutor v. Ntagerura et al.*, ICTR-99-46-T, Trial Chamber III, [Judgment and Sentence](#) ("Ntagerura Trial Judgment"), 25 February 2004, para. 32.

34. Sa i takon përcaktimit të identitetit të viktimave, natyra dhe shkalla e veprave penale të pretenduara mund ta bëjë të pamundur një përcaktim të tillë.⁵⁷ Në këto raste, mjafton identifikimi i viktimave si grup, apo një ide e numrit të tyre të përafërt.⁵⁸

35. Kur nuk mund të përcaktohet identiteti faktik i bashkëkryesve apo i anëtarëve të NKP-së, ata mund të identifikohen përmes një pseudonimi,⁵⁹ përkatësisë⁶⁰ ose një grupi të përcaktuar me parametra gjeografikë, kohorë ose të tjerë.⁶¹ Gjithsesi, nuk ekziston asnjë kërkesë për t'i identifikuar të gjithë individët e përfshirë në veprat penale që nuk konsiderohen si bashkëkryes të veprave të përfshira në aktakuzë apo si anëtarë të NKP-së.⁶²

36. Kur pretendohet se i akuzuari ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e një krimi, Aktakuza duhet të identifikojë veprimet ose praktikën e veçantë të sjelljes së të akzuarit që përbën bazën e akuzave të përfshira në aktakuzë.⁶³ Në lidhje me synimin kriminal, ka dy mënyra me të cilat mund të argumentohet gjendja mendore përkatëse:

⁵⁷ Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 43. *Për ngjashmëri* ICTR, *Rukundo v. Prosecutor*, ICTR-2001-70-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Rukundo Appeal Judgment"), 20 October 2010, para. 160; *Renzaho v. Prosecutor*, ICTR-97-31-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Renzaho Appeal Judgment"), 1 April 2011, para. 467.

⁵⁸ Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 43. *Për ngjashmëri*, ICTR, [Ntagerura Trial Judgment](#), para. 32; [Rukundo Appeal Judgment](#), para. 160; ICC, [Al Hassan 5 October 2018 Decision](#), para. 30; [Yekatom and Ngaïssona 15 May 2019 Decision](#), para. 41-42.

⁵⁹ Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 42. *Për ngjashmëri*, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT/TC, Trial Chamber, [Decision on Alleged Defects in the Form of the Amended Indictment](#) ("Ayyash et al. 12 June 2013 Decision"), 12 June 2013, para. 41.

⁶⁰ Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 42. *Për ngjashmëri*, ICTR, *Simba v. Prosecutor*, ICTR-01-76-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Simba Appeal Judgment"), 27 November 2007, para. 72; *Prosecutor v. Munyakazi*, ICTR-97-36A-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) ("Munyakazi Appeal Judgment"), 28 September 2011, para. 162.

⁶¹ Vendimi i Apelit në "Gucati dhe Haradinaj", para. 45; Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 42. *Për ngjashmëri*, ICTR, [Simba Appeal Judgment](#), para. 71-72; [Munyakazi Appeal Judgment](#), para. 162.

⁶² Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 42. *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-648, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Three Defences' Requests Regarding the Prosecution's Amended Charging Document](#), 25 June 2008, para. 24; STL, [Ayyash et al. 12 June 2013 Decision](#), para. 40; [Ayyash 28 September 2020 Decision](#), para. 51.

⁶³ *Gucati and Haradinaj Appeals Decision*, para. 53; Vendimi mbi Mocionin Paraparak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 42. *Për ngjashmëri*, ICTR, [Ntagerura Trial Judgment](#), para. 33; ICTY, [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 213.

(i) ose argumentohet vetë gjendja mendore, në ç' rast faktet përmes të cilave vërtetohet ekzistenca e gjendjes mendore janë rëndom aspekte të provave dhe nuk është nevoja të argumentohen në Aktakuzë; ose (ii) paraqiten faktet prej të cilave mund të deduktohet gjendja mendore.⁶⁴

37. Kur i akuzuari ngarkohet me përgjegjësi penale si epror, faktet materiale që duhen paraqitur në aktakuzë janë: (i) i akuzuari është eprori i vartësve të identifikuar mjaftueshëm, mbi të cilët ka pasur kontroll efektiv, në kuptimin e aftësisë e për të parandaluar ose ndëshkuar sjelljen kriminale të vartësve; (ii) aktet kriminale të kryera nga vartësit; (iii) synimi kriminal ose faktet përmes të cilave mund të konstatohet se i akuzuari ka ditur ose ka pasur arsye të dinte se krimet ishin në prag të kryerjes ose ishin kryer nga vartësit e tij ose të saj; dhe (iv) sjellja e të akuzuarit përmes së cilës konstatohet se nuk ka marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e akteve të tilla apo për t'i ndëshkuar personat që i kanë kryer.⁶⁵

38. Vartësit duhet të identifikohen mjaftueshëm që i akuzuari të konsiderohet se është informuar siç duhet.⁶⁶ Por kjo nuk do të thotë se vartësit duhen identifikuar me emër.⁶⁷ Kur identitetet ose rolet e vartësve nuk dihen, mjafton që të identifikohen si kategori ose grup.⁶⁸ Në lidhje me synimin kriminal vlen i njëjti parim i përshkruar në lidhje me ndihmën dhe inkurajimin. Në lidhje me sjelljen në bazë të së cilës i akuzuari mund të

⁶⁴ ICTY, [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 219; [Brđanin and Talić Decision](#), para. 33.

⁶⁵ ICTR, [Renzaho Appeal Judgment](#), para. 54; *Prosecutor v. Nahimana et al.*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), ("Nahimana Appeal Judgement") 28 November 2007, para. 323; ICTY, [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 218.

⁶⁶ ICTY, [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 218; *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT -08-91-PT, Trial Chamber, [Decision on Mićo Stanišić's and Stojan Župljanin's Motions on Form of the Indictment](#), ("Stanišić and Župljanin Decision"), 19 March 2009, para. 51.

⁶⁷ *Shih* ICTR, *Prosecutor v. Muvunyi*, ICTR-2000-55A-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 29 August 2008, para. 55 (ku thuhet se "[p]ër të qenë penalisht përgjegjës, nuk është nevoja që eprori të dijë identitetin e saktë të vartësve të tij a të saj që kanë kryer krimet").

⁶⁸ ICTR, *Prosecutor v. Karemera and Ngirumpatse*, ICTR-98-44-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 29 September 2014, para. 370; ICTY, [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 217; *Prosecutor v. Hadžić*, Trial Chamber, IT-04-75-PT, [Decision on Defence Motion Alleging Defects in Form of First Amended Indictment](#), 10 November 2011, para. 38; [Stanišić and Župljanin Decision](#), para. 51; *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-PT, Trial Chamber, [Decision on Preliminary Motions](#), ("Perišić Decision"), 29 August 2005, para. 35.

konstatohet se nuk ka marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar ose ndëshkuar kryerjen e krimeve, në shumë raste është e mjaftueshme të parashtrohet se i akuzuari nuk ka marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme.⁶⁹

39. Nuk lejohen formulime të papërcaktuara në lidhje me faktet ku mbështeten akuzat (të tilla si “përfshirë, ndër të tjera”),⁷⁰ veçse kur janë të nevojshme në raste të veçanta në bazë të rrethanave të çështjes apo të natyrës dhe shkallës së veprave penale dhe nuk krijojnë paqartësi lidhur me veprat penale për të cilat ngrihen akuzat.⁷¹ Informacioni duhet përshkruar me saktësi dhe plotësi, pa u shpërndarë.⁷² Gjithashtu, kur përcaktohet një kategori e caktuar në lidhje me faktet ku mbështeten akuzat dhe kur përdoret fjala “përfshirë” ose “ndër të cilët” a “ndër të cilat” për të dhënë një listë shembujsh joshterues që bëjnë pjesë në këtë kategori, përdorimi i “përfshirë” ose “ndër të cilët” a “ndër të cilat” lejohet. Por kur kategoria nuk përcaktohet, por vetëm i referohet një liste shembujsh joshterues që bëjnë pjesë në këtë kategori, paraprirë nga “përfshirë” ose “ndër të cilët” ose “ndër të cilat”, një përdorim i tillë i “përfshirë” ose “ndër të cilët” a “ndër të cilat” nuk lejohet, sepse do të mundësonte në mënyrë të palejueshme që fushëveprimi i kategorisë përkatëse të zgjerohej në fazën e gjykimit.

⁶⁹ ICTR, [Renzaho Appeal Judgment](#), para. 54, para. 54; [Nahimana Appeal Judgement](#), para. 323.

⁷⁰ Vendimi i Apelit në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 84; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 44; Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 18. *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-465-Red, Pre-Trial Chamber I, [Decision on the Confirmation of Charges](#), 16 December 2011, para. 82-83; *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-373, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the Confirmation of Charges Pursuant to Article 61\(7\)\(a\) and \(b\) of the Rome Statute](#), 23 January 2012, para. 99, 101 dhe 103; *Prosecutor v. Muthaura et al.*, ICC-01/09-02/11-382-Red, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the Confirmation of Charges Pursuant to Article 61\(7\)\(a\) and \(b\) of the Rome Statute](#), 23 January 2012, para. 106.

⁷¹ Vendimi i Apelit në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 84; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 44; Urdhri sipas rregullës 84(6). *Për ngjashmëri*, ICTY, *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30-PT, Trial Chamber, [Decision on Defence Preliminary Motions on the Form of the Indictment](#) (“Kvočka et al. 12 April 1999 Decision”), 12 April 1999, para. 26.

⁷² Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 10.

3. Aktakuzë me mangësi

40. Aktakuza ka mangësi kur nuk paraqet faktet mbi të cilat mbështeten akuzat apo kur i paraqet ato në mënyrë të pamjaftueshme apo të paqartë, duke krijuar paqartësi lidhur me akuzat e parashtruara, përfshirë edhe format e përgjegjësisë, dhe duke dëmtuar mundësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur.⁷³

41. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se konstatimet e lartpërmendura do të jenë informuese dhe udhëzuese për vlerësimin e mëposhtëm të mangësive konkrete të pretenduara në Aktakuzën e Konfirmuar.

B. KUNDËRSHTIMET NDAJ VENDIMIT TË KONFIRMIMIT DHE ZBATUESHMËRIA E KPPK-SË PËR FORMËN E AKTAKUZËS

1. Kundërshtimet ndaj Vendimit të Konfirmimit

(a) Parashtrimet

42. Mbrojtja e Veselit parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë gabim ligjor dhe faktik në përcaktimin e kritereve kontekstuale për krimet e luftës, kur u shpreh se: (i) ka ekzistuar një konflikt i armatosur jondërkombëtar në territorin e Kosovës prej më së paku marsit 1998, midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe forcave serbe; (ii) konflikti përfundoi afërsisht më 16 shtator 1999; dhe (iii) konflikti u shtri jashtë Kosovës, në Shqipëri.⁷⁴ Ajo argumenton më tej se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka trajtuar në mënyrë adekuate çështjen nëse ekzistonte një konflikt i armatosur jondërkombëtar në Shqipëri në kohën e ngjarjeve të pretenduara në Aktakuzën e Konfirmuar dhe se ai ka gabuar kur konfirmoi

⁷³ Vendimi i Apelit në "Gucati dhe Haradinaj", para. 38; Vendimi mbi Mocionin Paraprak në "Gucati dhe Haradinaj", para. 46. *Për ngjashmëri*, ICTY, *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-AR72, Appeals Chamber, [Decision on Application by Defence for Leave to Appeal](#), 30 November 2001, para. 11; *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 28 February 2005, para. 31; SCSL, *Prosecutor v. Sesay et al.*, SCSL-04-15-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 2 March 2009, para. 329.

⁷⁴ Mocioni Paraprak i Veselit, para. 2, 4-74.

Aktakuzën lidhur me incidente të pretenduara që kanë ndodhur tërësisht brenda Shqipërisë.⁷⁵ Konkretisht, Mbrojtja e Veselit parashtron se një vlerësim i fakteve tregon se në Shqipëri nuk ka pasur asnjë konflikt të armatosur dhe se, për pasojë, asnjë kryerje apo moskryerje penale që pretendohet të jetë bërë brenda atij shteti nuk mund të klasifikohet si krim lufte, por si një krim i zakonshëm që është objekt procedimi nga autoritetet shqiptare.⁷⁶

43. ZPS-ja përgjigjet se dy kundërshtimet në lidhje me shtrirjen kohore dhe gjeografike të konfliktit të armatosur shprehin thjesht mospajtim me Vendimin e Konfirmimit, përbëjnë një orvatje për të bërë ballafaqim ligjor të parakohshëm lidhur me aspekte të provave dhe janë çështje faktike që mbeten për t'u vendosur në gjykim.⁷⁷

44. Në kundërpërgjigje, Mbrojtja e Veselit argumenton se: (i) një interpretim kufizues, tekstual apo teleologjik i rregullës 86(7) të Rregullores, nën dritën e nenit 162(6) të Kushtetutës, neneve 19(2) dhe 39(1) të Ligjit dhe rregullave 4(1) dhe (3) dhe 5 të Rregullores të çon i gjithi në përfundimin se duhet mbështetur në atë dispozitë të KPPK-së që është e barasvlershme me rregullën 97 të Rregullores, pra në nenin 250 të KPPK-së, i cili nuk vendos kufizime të ngurta për paraqitjen e kundërshtimeve ndaj Aktakuzës dhe i lejon Mbrojtjes të paraqesë kundërshtime lidhur me mjaftueshmërinë e provave kundër të akuzuarit;⁷⁸ dhe (ii) parashtrimet e ZPS-së qartazi bien ndesh me konstatime të mëparshme të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("DHSGJK"), duke qenë se zbatimi i tyre, në thelb, do t'ia mohonte Mbrojtjes të drejtën për të apeluar vendimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake.⁷⁹

⁷⁵ Mocioni Paraprak i Veselit, para. 3, 75-77, poshtëshënimet 2, 103.

⁷⁶ Mocioni Paraprak i Veselit, para. 3, 78, 86-87.

⁷⁷ Përgjigjja Shtesë e ZPS-së, para. 1, 3-4, 6-7 dhe referencat aty.

⁷⁸ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 6-9.

⁷⁹ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 11-12, ku i referohet KSC-CC-PR-2017-01, F00004, DHSGJK, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017")*, 26 prill 2017, publik, para. 143.

(b) Konstatimi

45. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se neni 39(1) i Ligjit i referohet kompetencës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ndër të tjera “për të vendosur lidhur me parashtrirat paraprake, përfshirë ankesat ndaj aktakuzës”. Kjo dispozitë duhet lexuar së bashku me dispozitat e tjera, në veçanti me nenet 33(1)(b) dhe 40(1) të Ligjit, ku përmenden “ankesat ndaj formës së aktakuzës” (theksimi i shtuar). Më tej, në përputhje me Ligjin, rregulla 97(1)(b) e Rregullores thotë qartë se i akuzuari mund të paraqesë mocione paraprake, të cilat pretendojnë “mangësi në formën e aktakuzës”. Nën dritën e dispozitave të lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Ligji është i qartë në kuptimin që çdo “ankesë ndaj aktakuzës”, siç është thënë në nenin 39(1) të Ligjit, i përket formës së saj, e cila përfshin natyrën dhe shkakun e akuzave,⁸⁰ por jo themelin e akuzimeve apo provat mbi të cilat mbështeten akuzat.

46. Sa i takon argumentit të z. Veseli se kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara duhet të interpretohet nën dritën e nenit 250 të KPPK-së,⁸¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se: (i) detyra ia kërkon të gjykojë në përputhje me Ligjin si *lex specialis* dhe se, nëse duhet mbështetur në dispozita të tjera të së drejtës kosovare, këto dispozita duhen të jenë shprehimisht të përfshira në këtë Ligj; (ii) neni 250 i KPPK-së nuk është përfshirë shprehimisht në Ligj; (iii) kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara përmban dispozita të qarta dhe të plota lidhur me mocionet paraprake që kundërshtojnë Aktakuzën; (iv) neni 162(6) i Kushtetutës dhe neni 19(2) i Ligjit përcaktojnë se, në

⁸⁰ *Shih edhe* Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 9.

⁸¹ Neni 250 i KPPK-së, në pjesën përkatëse, thotë: “1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesë për [hedhjen poshtë të] aktakuzës, bazuar në këto arsye: 1.1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale; 1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale; 1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose 1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.”.

përcaktimin e rregullave të procedurës dhe provave, Dhomat e Specializuara “drejtohen”, ndër të tjera, nga KPPK-ja; këto dispozita nuk përcaktojnë se *Ligji* duhet interpretuar nën dritën e KPPK-së (përveç nëse përmendet shprehimisht në Ligj); (v) neni 162(6) i Kushtetutës dhe neni 19(2) i Ligjit nuk kanë të bëjnë me zbatimin por me krijimin e Rregullores, duke vendosur një detyrim për gjykatësit e Dhomave të Specializuara që marrin pjesë në plenare që të drejtohen nga KPPK-ja në hartimin dhe miratimin e Rregullores dhe të shtesave dhe ndryshimeve të saj; (vi) rregullat 4(1) dhe (3) dhe 5 të Rregullores, mbi të cilat Ligji ka epërsi, nuk mund të përdoren si bazë për të anashkaluar apo ndryshuar procedurat e përcaktuara në Ligj; dhe (vii) rregulla 4(1) e Rregullores thotë se Rregullorja interpretohet në pajtim me KPPK-në “nëse është e përshtatshme”, pra kur dispozitat e KPPK-së janë inkorporuar shprehimisht në Rregullore. Rrjedhimisht, neni 250 i KPPK-së është i pazbatueshëm në Dhomat e Specializuara.

47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej pretendimin e Mbrojtjes së Veselit se një kundërshtim ndaj aktakuzës përbën kundërshtim ndaj Vendimit të Konfirmimit, përfshirë edhe konstatimet juridike dhe faktike të bëra në të.⁸² Gjykatësi i Procedurës Paraprake nënvizon se Ligji nuk i parashikon Mbrojtjes mundësinë për të apeluar një vendim mbi shqyrtimin e aktakuzës. Gjithashtu, rregulla 86(7) e Rregullores, që rregullon procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe konfirmimit të aktakuzës, thotë shprehimisht se “Mbrojtja mund të paraqesë kundërshtime ndaj një vendimi mbi aktakuzën, vetëm në bazë të rasteve të parapara në rregullën 97”. Në këtë aspekt dhe krahas sa më lart, mbështetja nga ana e Mbrojtjes së Veselit në konstatimet e DHSGJK-së mbi nevojën që panelet e Dhomave të Specializuara të arsyetojnë në mënyrë adekuate vendimet e tyre⁸³ është e gabuar. Konstatimi përkatës i DHSGJK-së as përcakton një të drejtë për t’i apeluar vendime të tilla, dhe as nuk

⁸² Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 5-12, 17.

⁸³ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 11, duke iu referuar Aktvendimit të DHSGJK-së i datës 26 prill 2017, para. 143.

mund të interpretohet se krijon të drejtën për të apeluar vendimet sipas rregullës 86(5) të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, kur asnjë e drejtë e tillë nuk parashikohet në kuadrin ligjor të Dhomave të Specializuara.

48. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paneli i Gjykatës së Apelit ka konfirmuar se parashtrimet që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me bazën provuese të konfirmimit të një aktakuze nuk përbëjnë kundërshtime ndaj formës së aktakuzës sipas rregullës 97(1)(b) të Rregullores.⁸⁴ Ky konstatim i Gjykatës së Apelit konfirmon më tej natyrën e kufizuar të mocioneve sipas rregullës 97(1)(b).

49. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në përputhje me kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara, çdo mocion paraprak që kundërshton aktakuzën mund të bëhet vetëm në lidhje me formën e saj. Kjo kornizë ligjore nuk i jep të drejtë Mbrojtjes të kundërshtojë, me mocione paraprake të parashtruara sipas rregullës 97(1)(b) të Rregullores, mjaftueshmërinë faktike të konstatimeve të bëra në vendimin me të cilin konfirmohet aktakuza dhe/ose cilësimin e tyre juridik. Në këto kushte, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton më tej se Mocioni Paraprak i Veselit del jashtë kuadrin të mocioneve paraprake sipas rregullës 97(1)(b) të Rregullores dhe duhet rrëzuar.

2. Zbatueshmëria e KPPK-së për formën e aktakuzës

(a) Parashtrimet

50. Mbrojtja e Thaçit parashtron se, në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së, Aktakuza e Konfirmuar nuk e specifikon mjaftueshëm emërtimin ligjor të veprës penale përmes citimit të dispozitat e kodit përkatës.⁸⁵

⁸⁴ Vendimi i Apelit në "Gucati dhe Haradinaj", para. 23.

⁸⁵ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 61.

51. ZPS-ja përgjigjet se: (i) KPPK-ja nuk zbatohet për Dhomat e Specializuara, duke qenë se nuk është përfshirë shprehimisht në Ligj; (ii) gjithsesi, të akuzuarit akuzohen për kryerjen e krimeve në bazë të neneve 13-14 të Ligjit, të cilat i referohen së drejtës zakonore ndërkombëtare gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara dhe nenit 16(1) të Ligjit, lidhur me format e përgjegjesisë penale të përfshira në aktakuzë; dhe (iii) të akuzuarit nuk akuzohen në bazë të neneve 15 dhe 16(2)-(3) të Ligjit, që kanë të bëjnë me krime të parashikuara në ligje penale materiale në fuqi në Kosovë.⁸⁶

52. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se, në zbatimin e nenit 19(2) të Ligjit dhe të rregullës 4(1) të Rregullores, është e përshtatshme të sigurohet që Aktakuza e Konfirmuar është në përputhje me KPPK-në.⁸⁷ Gjithashtu, siç parashikohet në rregullën 4(3) të Rregullores, çdo paqartësi e Rregullores duhet zgjidhur duke u bazuar në interpretimin më të favorshëm për të akuzuarin, që në këtë rast do të përbënte kërkesë që Aktakuza e Konfirmuar të interpretohet në pajtim me KPPK-në.⁸⁸

(b) Konstatimi

53. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, sipas nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përcaktojë ndër të tjera krimin ose krimet për të cilat akuzohet i dyshuari. Sa u takon krimeve që duhen përfshirë në aktakuzat para Dhomave të Specializuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se këto, sipas nenit 6 të Ligjit, janë: (i) krimet e parashikuara në nenet 13-14 të Ligjit,⁸⁹ në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën përkatëse;⁹⁰ (ii) në varësi të nenit 12 të Ligjit, krimet në bazë të ligjeve penale materiale në fuqi sipas legjislacionit kosovar në kohën përkatëse, për aq sa nuk bien ndesh me të drejtën

⁸⁶ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 43.

⁸⁷ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 17-18.

⁸⁸ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 18-19.

⁸⁹ Neni 6(1) i Ligjit.

⁹⁰ Neni 12 i Ligjit.

zakonore ndërkombëtare;⁹¹ dhe (iii) disa vepra të caktuara penale të parashikuara në Kodin Penal të Kosovës ("KPK"), kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe zyrtarët e Dhomave të Specializuara.⁹²

54. Sa i takon argumentit të Mbrojtjes së Thaçit se Aktakuza e Konfirmuar lipset të respektojë kriteret e veçanta të nenit 241 të KPPK-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se ai ka për detyrë ta zbatojë Ligjin si *lex specialis* dhe se neni 241 i KPPK-së nuk është përfshirë shprehimisht në Ligj. Prandaj, në përputhje me nenin 3(2) dhe (4) të Ligjit, neni 241, nënpika 1.5., i KPPK-së⁹³ nuk është i zbatueshëm në Dhomat e Specializuara.

55. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se rregulla 86(3) e Rregullores përcakton shprehimisht se në aktakuzë duhen përcaktuar vepra ose veprat penale për të cilat akuzohet i dyshuari. Në këtë kuadër, rikujtojmë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëroi ZPS-në ta ridorëzonte aktakuzën me përshkrimin e saktë të krimeve (cilësimin ligjor), në bazë të rregullës 86(4)(b) të Rregullores.⁹⁴ Krahas kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se neni 241 i KPPK-së zbatohet në rastet kur aktakuza e ngarkon të dyshuarin me krime të tjera nga ato që përmenden në nenin 6(2) të Ligjit dhe, për rrjedhojë, nuk ka të bëjë me krimet e parashikuara në Ligj. Në këto kushte, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se rregulla 86(3) e Rregullores nuk mund të interpretohet se kërkon që aktakuzat e ngritura para Dhomave të Specializuara të përmendin emërtimin ligjor të veprës penale siç është i përcaktuar në KPK. Gjithashtu, dhe më e rëndësishmja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në Aktakuzën e Konfirmuar të akuzuarit akuzohen për kryerjen e: (i) përndjekjes, burgimit, akteve të tjera çnjerëzore, torturës, vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë, si krime kundër njerëzimit në bazë të nenit 13(1)(a),(e)-(f) dhe (h)-

⁹¹ Neni 15(1) i Ligjit.

⁹² Nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit.

⁹³ Neni 241, nënpika 1.5. i KPPK-së thotë: "Aktakuza përmban [...] 1.5. emërtimin ligjor të veprës penale duke iu referuar dispozitave të [KPK-së]".

⁹⁴ Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 23-26, 27(b).

(j) të Ligjit; dhe (ii) ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme, si krime lufte në bazë të nenit 14(1)(c) dhe (c)(i) të Ligjit, në përputhje me format e përgjegjesisë penale të parashikuara në nenin 16(1)(a) dhe (c) të Ligjit.⁹⁵ Ata nuk akuzohen për kryerjen e veprave penale të parashikuara në legjislacionin kosovar. Rrjedhimisht, të akuzuarit janë informuar konkretisht për emërtimin ligjor të veprës penale me citimin e dispozitës ligjore të zbatueshme.

56. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86(3) të Rregullores, Aktakuza e Konfirmuar i përcakton në mënyrë adekuate krimet – brenda juridiksionit lëndor të Dhomave së Specializuara dhe në përputhje me nenet 3(2)(b) dhe (4) dhe 12 të Ligjit – në ngarkim të të akuzuarve, përfshirë edhe përmes përmendjes së dispozitave përkatëse sipas Ligjit. Rrjedhimisht, kundërshtimi i Mbrojtjes së Thaçit në këtë aspekt duhet rrëzuar.

C. ARGUMENTIMI I NKP-SË

1. Qëllimi i përbashkët

(a) Parashtrimet

57. Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit parashetrojnë se argumentimi i qëllimit të përbashkët në Aktakuzën e Konfirmuar është i mangët sepse: (i) nuk është një qëllim i përbashkët për kryerjen e një krimi të parashikuar në Ligj; dhe (ii) ZPS-ja nuk identifikon se cilat krime bënin pjesë me siguri në qëllimin e përbashkët dhe cilat, në alternativë, ishin pasoja të parashikueshme të zbatimit të tij.⁹⁶

⁹⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 172-173.

⁹⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 15-22; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 38-46, 61-64; Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 4-6; Kundërpërgjigja e Selimit, para. 27-28.

58. Më konkretisht, për çështjen e parë, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit argumentojnë se qëllimi i përbashkët i pretenduar në këtë çështje gjyqësore – “për marrjen dhe ushtrimin e kontrollit mbi të gjithë Kosovën” – nuk i përmbahet përkufizimit sipas të cilit qëllimi i përbashkët duhet “të përbëjë ose të përfshijë kryerjen e një krimi të parashikuar në Statut” (“përkufizimi sipas çështjes *Tadiq*”).⁹⁷ Ato argumentojnë se Dhomat e Specializuara nuk duhet të ndjekin një përkufizim të zgjeruar, sipas të cilit qëllimi i përbashkët nuk ka nevojë të përbëjë apo të përfshijë kryerjen e një krimi por thjesht të menduarit e krimeve si mjete për të arritur objektivin.⁹⁸ Ato parashtrojnë se kjo do ta zgjeronte në mënyrë të papërshtatshme shtrirjen e përgjegjësisë penale.⁹⁹ Mbrojtja e Selimit parashton se, për ta parandaluar këtë, ZPS-së duhet t’i kërkohet ta ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar, që aty për të shprehur se anëtarët e pretenduar të NKP-së në këtë çështje gjyqësore (“anëtarët e NKP-së”) ranë dakord se qëllimi i përbashkët do të përfshinte domosdoshmërisht mjete të paligjshme.¹⁰⁰

59. Për çështjen e dytë, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit parashtrojnë se argumentimit të ZPS-së i mungon qartësia sepse ajo pretendon se secili prej krimeve të përfshira në aktakuzë, dhe me gjasë të gjitha syresh, mund të ishin ose pjesë e qëllimit të përbashkët, ose pasojë e parashikueshme e zbatimit të tij.¹⁰¹ Kjo, sipas Mbrojtjes së Thaçit, e zhvesh qëllimin e përbashkët nga vetë krimet që pretendohet se përfshin.¹⁰² Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit shtojnë se ZPS-ja duhet të identifikojë se cilat krime bënin pjesë me siguri në qëllimin e përbashkët dhe, në alternativë, cilat, , ishin pasojë e parashikueshme e zbatimit të tij.¹⁰³

⁹⁷ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 15-18, *ku i referohet ICTY, Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 15 July 1999, para. 227; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 38-40.

⁹⁸ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 19-20; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 41.

⁹⁹ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 20; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 42-46.

¹⁰⁰ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 45-46.

¹⁰¹ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 22; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 63.

¹⁰² Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 22; *shih edhe* Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 5.

¹⁰³ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 64; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 6.

60. ZPS-ja përgjigjet se: (i) në fakt, Mbrojtja nuk po kundërshton formën e Aktakuzës e Konfirmuar, por konteston mjaftueshmërinë faktike dhe juridike të parashtrimit të çështjes nga ZPS-ja; (ii) qëllimi i përbashkët gjithsesi është qartësisht dhe vetvetiu kriminal, duke qenë se objektivi i tij do të arrihej përmes mjeteve që përfshinin edhe krimet e përfshira në aktakuzë; (iii) në kundërshtim nga sa parashtron Mbrojtja e Selimit, nuk kërkohet që mjetet kriminale të jenë të nevojshme për të arritur objektivin e qëllimit të përbashkët; (iv) Aktakuza e Konfirmuar e pranon se, që të lindë përgjegjësia penale, duhet që të paktën një krim të përfshihet në qëllimin e përbashkët; dhe (v) identifikimi i krimeve, pra se cilat bëjnë pjesë në qëllimin e përbashkët dhe cilat bëjnë pjesë në pasojat e parashikueshme të tyre, është çështje provash në gjykim.¹⁰⁴

(b) Konstatim

(i) *Kuadri i qëllimit të përbashkët*

61. Sa i takon çështjes së parë të ngritur nga Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren që në fillim se është e vërtetë që qëllimi i përbashkët i pretenduar “për marrjen dhe ushtrimin e kontrollit mbi të gjithë Kosovën”, nuk do të përbënte vetëm në vetvete, pa aspekte të tjera, një qëllim të përbashkët kriminal që bart përgjegjësi penale për NKP. Mirëpo, nuk është ky qëllimi i përbashkët që argumentohet në Aktakuzën e Konfirmuar. Përkundrazi, Aktakuza e Konfirmuar pretendon se, së paku midis marsit 1998 dhe shtatorit 1999, të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të NKP-së “kishin qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën *përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë*”.¹⁰⁵ Pretendohet se

¹⁰⁴ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 8-11.

¹⁰⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 32 (theksimi i shtuar).

qëllimi i përbashkët “përfshinte krimet e përndjekjes, burgosjes, arrestimit dhe ndalimit arbitrar ose të paligjshëm, akte të tjera çnjerëzore, trajtimin mizor, torturën, vrasjen dhe zhdukjen me forcë të personave”.¹⁰⁶ Në dallim nga çfarë sugjerojnë Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit, qëllimi i përbashkët i pretenduar në Aktakuzën e Konfirmuar nuk mbetet brenda marrjes dhe ushtrimit të kontrollit mbi Kosovën.

62. Gjithashtu, për aq sa parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Selimit kanë të bëjnë me përkufizimin juridik të qëllimit të përbashkët, pra, nëse Dhomat e Specializuara duhet të përdornin përkufizimin sipas çështjes *Tadiq* apo – atë që Mbrojtja e quan përkufizim i zgjeruar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo është çështje juridike dhe nuk ka të bëjë me konkretësinë apo qartësinë e akuzave të ngritura. Mbrojtja është e lirë ta ngrejë këtë çështje në gjykim, nëse dëshiron, fazë në të cilën mund të bëjë parashtrime si për faktet e pretenduara, ashtu edhe për dispozitat ligjore të zbatueshme.

63. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rrëzon kundërshtimin e Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Selimit në këtë aspekt.

(ii) *Argumentimi alternativ i formës bazë dhe formës së zgjeruar të NKP-së*

64. Për t’iu kthyer çështjes së dytë të ngritur nga Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar pretendon se të akuzuarit “kishin qëllimin e përbashkët të kryerjes së secilit prej krimeve të paraqitura [...] së bashku me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët”.¹⁰⁷ Si alternativë, “për disa nga krimet që nuk ishin pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët”, Aktakuza pretendon se ishin pasojë e

¹⁰⁶ Aktakuza e Konfirmuar, para. 32.

¹⁰⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 33.

parashikueshme e zbatimit të qëllimit të përbashkët dhe se të akuzuarit morën pjesë në NKP dhe e morën përsipër atë rrezik me vullnet të lirë.¹⁰⁸

65. Pra, Aktakuza e Konfirmuar argumenton se të akuzuarit janë përgjegjës, së pari, sipas formës bazë të NKP-së (“NKP I”) për të gjitha krimet e për të cilat ngrihet akuzë, për aq sa disa prej këtyre krimeve nuk bëjnë pjesë në qëllimin e përbashkët, sipas formës së zgjeruar të NKP-së (“NKP III”). Aktakuza e Konfirmuar i bën të ditur Mbrojtjes se përgjegjësia penale për NKP III argumentohet si alternativë ndaj NKP I, në lidhje me të gjitha krimet e përfshira në aktakuzë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk konstaton asnjë mangësi në këtë. ZPS-ja mund ta akuzojë të akuzuarin për disa forma NKP-je, mjafton që të tregojë qartë se cilat forma pretendohen dhe këtë mund ta bëjë në lidhje me të gjitha krimet për të cilat ngrihet akuzë.¹⁰⁹

66. Aktakuza e Konfirmuar e bën të qartë, përmes përdorimit të fjalës “disa” në paragrafin 34, se të paktën njëri prej krimeve pretendohet se ka qenë pjesë e qëllimit të përbashkët. Përtej kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ZPS-së nuk i kërkohet të përcaktojë konkretisht se cilat krime bien me siguri brenda qëllimit të përbashkët dhe cilat jo, kur argumenton përgjegjësinë penale në bazë të NKP III si alternativë ndaj NKP I. Do t’i takojë trupit gjykues të konstatojë, pas paraqitjes së provave, se cili krim apo cilat krime të pretenduara kanë bërë pjesë në qëllimin e përbashkët dhe cilat kanë qenë pasojat e parashikueshme të tyre, nëse ka pasur.¹¹⁰ Siç përmendet më lart, Mbrojtja vihet në dijeni se paraqitet

¹⁰⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 34.

¹⁰⁹ [Prlić et al. Appeal Judgment](#), para. 3014; ICTY, *Prosecutor v. Brđanin and Talić*, IT-99-36, Trial Chamber, [Decision on Form of Further Amended Indictment and Prosecution Application to Amend](#) (“Brđanin and Talić Decision”), 26 June 2001, para. 40-41; SCSL, [Brima et al. Appeal Judgment](#), para. 85; ICTR, *Prosecutor v. Simba*, ICTR-01-76-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 27 November 2007, para. 77.

¹¹⁰ *Për ngjashmëri*, ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al. (Čelebići case)*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 20 February 2001, para. 400.

përgjegjësia penale për NKP III, si alternativë ndaj NKP I, në lidhje me të gjitha krimet për të cilat ngrihet akuzë.

67. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se argumentimi i qëllimit të përbashkët të NKP-së të pretenduar në Aktakuzën e Konfirmuar nuk ka mangësi dhe i rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Selimit në këtë aspekt.

2. Shumësia e personave

(a) Parashtrimet

68. Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Krasniqit dhe Mbrojtja e Selimit parashtrojnë se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi sepse: (i) nuk identifikohen në mënyrë adekuate anëtarët e NKP-së; dhe (ii) argumentimit lidhur me instrumentet e NKP-së – domethënë, me individët që nuk ishin anëtarë të NKP-së, por pretendohet se u përdorën nga anëtarët e NKP-së për të kryer krime për realizimin e qëllimit të përbashkët (“instrumentet”)¹¹¹ – i mungon qartësia dhe konkretësia.¹¹²

69. Më konkretisht, lidhur me anëtarët e NKP-së, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Selimit parashtrojnë, së pari, se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi sepse nuk jepet në mënyrë shteruese lista e anëtarëve të NKP-së, siç e tregon përdorimi i frazës “Ndër anëtarët [...] ishin” në paragrafin 35 të Aktakuzës së Konfirmuar.¹¹³ Mbrojtja e Selimit parashtron se fraza “Ndër anëtarët [...] ishin” duhet hequr ose duhet zëvendësuar me “Anëtarët [...] ishin”.¹¹⁴ Së dyti, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Krasniqit parashtrojnë se, përveç individëve të përmendur me emër, Aktakuza e Konfirmuar nuk i identifikon me konkretësi të mjaftueshme anëtarët

¹¹¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 35.

¹¹² Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 23-28; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 41-47; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 31-37.

¹¹³ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 23; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 32.

¹¹⁴ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 32; Kundërpërgjigja e Selimit, para. 19(b), 22.

e tjerë të NKP-së, përmes përdorimit, për shembull, të treguesve gjeografikë apo kohorë, apo cilësinë me të cilën pretendohet se ishin përfshirë në krimet për të cilat ngrihet akuzë.¹¹⁵ Mbrojtja e Krasniqit dhe Mbrojtja e Selimit nënvizojnë se, si pasojë, NKP-ja mund të përfshinte çdo anëtar të UÇK-së, që do të thotë një numër i panjohur dhe i paidentifikueshëm individësh.¹¹⁶ Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit argumenton se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi sepse nuk përcakton nëse anëtarë të NKP-së ishin të gjithë, apo vetëm disa persona prej grupeve të gjera të personave të identifikuar.¹¹⁷

70. Sa u takon instrumenteve, ekipet e Mbrojtjes të tre të akuzuarve parashtrojnë se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi sepse nuk bën dallimin midis anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së, megjithëse kanë role të ndryshme dhe për ta zbatohen kritere të ndryshme për përcaktimin e ekzistencës së synimit kriminal.¹¹⁸ Mbrojtja e Krasniqit shton gjithashtu se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi sepse nuk identifikon se si krimet e kryera nga instrumentet mund t'u ngarkohen anëtarëve të NKP-së dhe përmes cilit anëtar.¹¹⁹

71. ZPS-ja përgjigjet se: (i) anëtarët e NKP-së janë identifikuar mjaftueshëm me emër dhe/ose post, kategori ose grup – përfshirë anëtarësinë në disa organe ose shërbime të caktuara brenda UÇK-së dhe në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës ("QPK") – sipas gradës, njësisë, zonës operative, bazës, komandantit, shtabit dhe vendndodhjeve të tjera, akteve, ngjarjeve dhe periudhave kohore; (ii) akuzat e ngritura dhe përgjegjësia e të akuzuarve nuk varen nga numri i gjithsejtë i anëtarëve të NKP-së, që do të mbetet i paditur madje edhe në fund të procesit

¹¹⁵ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 23-26; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 45; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 7.

¹¹⁶ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 45; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 33; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 23.

¹¹⁷ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 45.

¹¹⁸ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 27; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 47; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 34-35; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 8; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 23-24.

¹¹⁹ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 46-47.

gjqësor, dhe nuk ndikon në numrin e anëtarëve të ditur të NKP-së që identifikohen në Aktakuzën e Konfirmuar; dhe (iii) Mbrojtja nuk shpjegon se si është i papërcaktuar dhe i paqartë cilësimi alternativ i anëtarëve të NKP-së si instrumente.¹²⁰

(b) Konstatim

(i) *Identiteti i anëtarëve të NKP-së*

72. Aktakuza e Konfirmuar në këtë çështje gjyqësore argumenton se anëtarët e NKP-së ishin katër të akuzuarit dhe

anëtarët e tjerë [...] [ndër të cilët] ishin Azem SYLA, Lahi BRAHIMAJ, Fatmir LIMAJ, Sylejman SELIMI, Rrustem MUSTAFA, Shukri BUJA, Latif GASHI dhe Sabit GEÇI, si dhe disa udhëheqës të tjerë politikë dhe ushtarakë të UÇK-së dhe QPK-së, ndër të cilët edhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm; ministra dhe zëvendësministra të QPK-së; komandantë të zonave të UÇK-së, zëvendëskomandantë të zonave dhe anëtarë të tjerë të shtabeve të komandave të zonave; komandantë të brigadave dhe njësiteve; komandantë dhe anëtarë të shërbimeve policore dhe të zbulimit të UÇK-së dhe QPK-së; ushtarë të tjerë të UÇK-së dhe zyrtarë të tjerë të QPK-së; si dhe të tjerë që vepronin në emër të UÇK-së dhe QPK-së.¹²¹

73. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren fillimisht se Aktakuza e Konfirmuar identifikon me emër 12 prej anëtarëve të NKP-së (ndër të cilët edhe katër të akuzuarit).¹²²

74. Së dyti, anëtarë të tjerë të NKP-së të cilëve nuk u përmendet emri identifikohen: (i) me anë të përkatësisë dhe postit (“udhëheqës politikë dhe ushtarakë të UÇK-së dhe QPK-së”, “ministra dhe zëvendësministra të QPK-së”, “zyrtarë të tjerë të QPK-së”); (ii) me anë të përkatësisë dhe gradës (“komandantë të zonave të UÇK-së”, “zëvendëskomandantë të zonave”, “komandantë të

¹²⁰ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 12-16.

¹²¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 35.

¹²² Aktakuza e Konfirmuar, para. 32-33, 35.

brigadave dhe njësiteve”, “komandantë [...] të shërbimeve policore dhe të zbulimit të UÇK-së dhe QPK-së”, “ushtarë [...] të UÇK-së”); ose (iii) me anë të anëtarësisë (“anëtarë [...] të Shtabit të Përgjithshëm”, “anëtarë [...] të shtabeve të komandave të zonave”, “anëtarë të shërbimeve policore dhe të zbulimit të UÇK-së dhe QPK-së”).¹²³

75. Së treti, në kundërshtim me parashtrimet e bëra nga Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Krasniqit,¹²⁴ Aktakuza e Konfirmuar siguron më shumë konkretësi në pjesë të tjera të ndryshme në të gjithë dokumentin, ku anëtarët e NKP-së identifikohen me parametra gjeografikë, kohorë e të tjerë. Kjo përfshin referimin me: zona operative,¹²⁵ njësi,¹²⁶ komandantë,¹²⁷ shtabe dhe baza,¹²⁸ qendra ndalimi të pretenduara,¹²⁹ vendndodhje të tjera,¹³⁰ si edhe informacione të tjera identifikuese.¹³¹ Gjithashtu, identifikohen me anë të përmendjes së kohës përkatëse që lidhet me secilin vend të gjithë anëtarët e UÇK-së në vendet ku pretendohet se janë kryer krimet e paraqitura në Aktakuzë.

76. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konstaton të pabazë parashtrimin e Mbrojtjes së Selimit se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi ngaqë kategoritë apo

¹²³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 35.

¹²⁴ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 23-26; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 45.

¹²⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 60, 67, 68, 71, 72, 93 (p.sh. Zona Operative e Drenicës, Zona Operative e Llapit).

¹²⁶ Aktakuza e Konfirmuar, para. 72, 77 (p.sh. anëtarët e njësitit gueril BIA në Zonën Operative të Llapit, anëtarë të [REDAKTUAR] në Zonën Operative të Nerodimes).

¹²⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 60, 61, 67, 68, 77.

¹²⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 61, 63, 66, 80, 81, 90, 92, 137, 170 (p.sh. shtabet e UÇK-së në Jabllanicë, Drenoc, [REDAKTUAR], në një ish-shkollë me konvikt dhe në konviktin e saj në Gjilan, [REDAKTUAR] Novobërdë, në Likoc ose një bazë e UÇK-së në [REDAKTUAR]).

¹²⁹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 62, 65, 75, 78, 79, 81, 83, 84, 86, 87, 88, 89, 91, 140-142, 158-162, 164, 165 (p.sh. kompleksi në Llapushnik; ish-stacioni i policisë në Malishevë; shtëpi dhe ndërtesat për qark saj afër Kleçkës; kazerma ushtarake të UÇK-së në Cahan, rrethi i Hasit, Shqipëri; ish-fabrikë metali në Kukës, rrethi i Kukësit, Shqipëri; shtëpi në [REDAKTUAR] ose në Ferizaj ose në rrethinë; [REDAKTUAR] Prizrenit, [REDAKTUAR] Prizren, [REDAKTUAR] Prizren; ish-stacioni i policisë në Suharekë; kazerma e UÇK-së në Jabllanicë).

¹³⁰ Aktakuza e Konfirmuar, para. 74, 80, 81, 82, 126-128, 144, 145, 151-157, 163.

¹³¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 44, 73 [REDAKTUAR]).

grupet e lartpërmendura përbëhen nga një numër i papërcaktuar anëtarësh të panjohur dhe të paidentifikueshëm.¹³² Fakti se numri i anëtarëve të pretenduar të NKP-së është relativisht i lartë nuk përbën mangësi të Aktakuzës së Konfirmuar, por pasqyron shtrirjen e çështjes.¹³³

77. Gjithashtu, në kundërshtim nga parashtrimi i Mbrojtjes së Krasniqit,¹³⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mendon se është e nevojshme që Aktakuza e Konfirmuar të përcaktojë nëse të gjithë apo vetëm disa prej individëve të këtyre kategorive apo grupeve ishin anëtarë të NKP-së.¹³⁵ Kjo është një çështje që do të diskutohet në gjykim në bazë të provave. Ajo që ka rëndësi për të përmbushur kriteret në lidhje me njoftimin është që Aktakuza e Konfirmuar përmban kategoritë ose grupet e personave që pretendohet se bënin pjesë në NKP (kur nuk është i mundshëm identifikimi konkret i çdo anëtari të NKP-së).

78. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se aktakuza duhet t'i identifikojë anëtarët e NKP-së të paktën sipas kategorisë ose grupit. Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, fraza “të tjerë që vepronin në emër të UÇK-së dhe QPK-së” nuk e përmbush këtë kriter dhe është palejueshmërisht e mjegullt. Rrjedhimisht, ZPS-ja udhëzohet të heqë fjalët “dhe të

¹³² Mocioni Paraprak i Selimit, para. 33.

¹³³ *Shih për ngjashmëri ICTY, Prosecutor v. Šešelj*, IT-03-67/PT, Trial Chamber, *Decision on Motion by Vojislav Šešelj Challenging Jurisdiction and Form of Indictment*, 26 May 2004, para. 59 (ku konstatohet se identiteti i pjesëmarrësve të NKP-së nuk është argumentuar mjaftueshëm me dhënien e emrave të disa pjesëmarrësve dhe me identifikimin e të tjerëve duke u përmendur si kategori, ndër të cilat: “ushtria e Republika Srpska Krajina”, “ushtria e Republika Srpska”, “forcat policore lokale serbe, të Republikës së Serbisë dhe të Republika Srpska” dhe “Dega e Sigurimit të Shtetit /Drzavna bezbednost/ e Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë”); ICTR, *Prosecutor v. Karemera and Ngirumpatse*, ICTR-98-44-A, Appeals Chamber, *Judgement*, 29 September 2014, para. 150 (ku konstatohet se nuk ka asnjë gabim në përshkrimin që u bën Dhoma e Gjyimit anëtarëve të NKP-së si “udhëheqës politikë”, “persona me pushtet në ushtri, *Interahamwe* dhe administratën territoriale” dhe “afaristë me ndikim”); SCSL, *Prosecutor v. Sesay et al.*, SCSL-04-15-T, Trial Chamber, *Judgement*, 2 March 2009, para. 362-367 (ku konstatohet se identiteti i pjesëmarrësve të NKP-së është argumentuar mjaftueshëm me dhënien e emrave të disa pjesëmarrësve dhe me identifikimin e të tjerëve si “eprorë të tjerë në RUF, Juntë dhe forcat e AFRC-së/RUF-së”).

¹³⁴ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 45.

¹³⁵ *Për ngjashmëri, ICTY, Prlić et al. Appeal Judgment*, para. 1522.

tjerë që vepronin në emër të UÇK-së dhe QPK-së” nga paragrafi 35 i Aktakuzës së Konfirmuar.

79. Për t’iu kthyer parashtrimin të Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Selimit se lista e anëtarëve të NKP-së nuk është paraqitur në mënyrë shteruese,¹³⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paragrafi 35 i Aktakuzës së Konfirmuar përdor në dy raste frazat “ndër anëtarët e tjerë” dhe “ndër të cilët” (rreshti i parë dhe rreshti i katërt). Sa i takon frazës “ndër anëtarët e tjerë” të përdorur në paragrafin 35, rreshti i parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ajo krijon paqartësi sepse i jep mundësi ZPS-së të parashtrojë se individë dhe grupe personash të tjerë, që aktualisht nuk përmenden i në Aktakuzën e Konfirmuar, ishin anëtarë të NKP-së. Sa i takon frazës “ndër të cilët” në paragrafin 35, rreshti i katërt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se nuk është përdorur si formulim me kufij të papërcaktuar. Përkundrazi, ai ka për qëllim të ofrojë më shumë konkretësi në lidhje me “disa udhëheqës të tjerë politikë dhe ushtarakë të UÇK-së dhe QPK-së”. Kjo duket qartë nga teksti i Aktakuzës së Konfirmuar.¹³⁷

80. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të dorëzojë një version të korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar ku: (i) të heqë frazën “si dhe të tjerë që vepronin në emër të UÇK-së dhe QPK-së” në paragrafin 35, rreshti i tetë; dhe (ii) të zëvendësojë frazën “Ndër anëtarët e tjerë” me “Anëtarët e tjerë” në paragrafin 35, rreshti i parë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, me këto ndryshime dhe kur lexohet në kuadër të Aktakuzës së

¹³⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 23; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 32.

¹³⁷ Duke vërejtur parashtrimin e Mbrojtjes së Krasniqit të bërë gjetkë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake sqaron se e njëjta vlen edhe për paragrafin 37 të Aktakuzës së Konfirmuar, ku fraza “ndër të cilët” përdoret për të prezantuar shembuj të grupeve ose kategorive të anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së. Këto grupe ose kategori tashmë janë përfshirë në përkufizimin e anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së dhe, për rrjedhojë, përdorimi i frazës “ndër të cilët” në paragrafin 37 nuk e zgjeron kuadrin e -përkufizimit; *shih* Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 23(a). I njëjti parim vlen edhe për paragrafët 39, 42 dhe 44, rreshti i dytë, të Aktakuzës së Konfirmuar.

Konfirmuar në tërësi, argumentimi i anëtarësisë në NKP nuk ka mangësi dhe i jep Mbrojtjes konkretësi të mjaftueshme.

(ii) *Përkufizimi i instrumenteve*

81. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar argumenton se, si alternativë, disa ose të gjithë anëtarët e NKP-së të përmendur në paragrafin 35 nuk ishin anëtarë të NKP-së por përdorëshin nga anëtarët e NKP-së për të kryer krime për realizimin e qëllimit të përbashkët, pra ishin instrumente.¹³⁸ Rrjedhimisht, Aktakuza e Konfirmuar i përkufizon instrumentet në lidhje me të njëjtët individë, kategori dhe grupe si edhe anëtarët e NKP-së, për të cilët Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar se janë paraqitur me konkretësi të mjaftueshme.

82. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se ZPS-së i lejohet të parashtojë se të gjithë ose disa individë të përmendur në paragrafin 35 të Aktakuzës së Konfirmuar ishin anëtarë ose instrumente të NKP-së, nëse e argumenton këtë në alternativë. Rikujtojmë se parashtrimi alternativ lejohet dhe është, në fakt, një praktikë mjaft e njohur në gjykatat penale ndërkombëtare.¹³⁹ I takon Trupit Gjykses të përcaktojë me më shumë konkretësi se kush ishte anëtar i NKP-së dhe kush ishte instrument, pas paraqitjes së provave. Në funksion të informimit të të akuzuarve për akuzat e ngritura, Mbrojtja paralajmërohet se, në qoftë se për disa prej anëtarëve të pretenduar të NKP-së konstatohet se nuk kanë qenë anëtarë, për ta gjithësi pretendohet se kanë qenë instrumente.¹⁴⁰

¹³⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 35.

¹³⁹ *Shih më lart* para. 65 dhe referencat aty. *Shih edhe* ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-309, Pre-Trial Chamber II, [Decision Pursuant to Article 61\(7\)\(a\) and \(b\) of the Rome Statute on the Charges of the Prosecutor Against Bosco Ntaganda](#), 9 June 2014, para. 100.

¹⁴⁰ *Për ngjashmëri*, ICTY, *Prosecutor v. Hadžić*, IT-04-75-PT, Trial Chamber, [Decision on Defence Motion Alleging Defects in Form of First Amended Indictment](#), 10 November 2011, para. 17.

83. Sa i takon parashtrimet të Mbrojtjes së Krasniqit se Aktakuza e Konfirmuar duhet të identifikojë se përmes cilit anëtar të NKP-së do të ngarkohen krimet,¹⁴¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se edhe kjo është një çështje që do të vendoset në gjykim.

84. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se argumentimi lidhur me instrumentet e pretenduara, sikurse është formuluar në paragrafin 35 të Aktakuzës së Konfirmuar, nuk ka mangësi dhe i rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes së Thaçit, Mbrojtjes së Krasniqit dhe Mbrojtjes së Selimit në këtë aspekt.

3. Kontributi i të akuzuarve në NKP

(a) Parashtrimet

85. Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Krasniqit dhe Mbrojtja e Selimit parashtrojnë se kontributet e të akuzuarve në NKP nuk paraqiten me konkretësi të mjaftueshme, çka ua bën të pamundur përgatitjen e mbrojtjes.¹⁴²

86. Më konkretisht, në lidhje me rastet kur të akuzuarit pretendohet se kanë marrë pjesë personalisht në krimet për të cilat ngrihet akuzë, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Krasniqit parashtrojnë se argumentimi i është i mangët sepse: (i) nuk janë përshkruar në mënyrë shteruese; dhe (ii) nuk jepen me konkretësi të mjaftueshme datat, vendet, identitetet e viktimave dhe veprimet e të akuzuarve.¹⁴³ Në lidhje me këtë, Mbrojtja e Krasniqit konkretisht kërkon që të hiqen frazat “ndër të tjera” dhe “si në rastet që diskutohen në vijim”, në paragrafin 40 të Aktakuzës

¹⁴¹ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 46-47.

¹⁴² Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 29-34; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 15-27; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 47-60; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 17.

¹⁴³ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 30-33, 59; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 21-22; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 10; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 18-23.

së Konfirmuar.¹⁴⁴ Ajo ka kundërshtim edhe për faktin se sjellja e z. Krasniqi nuk argumentohet veçmas nga ajo e të akuzuarve të tjerë.¹⁴⁵

87. Sa u takon kontributeve të tjera të pretenduara të të akuzuarve (përveç pjesëmarrjes së tyre personale në krimet për të cilat ngrihen akuzat), Mbrojtja e të tre të akuzuarve parashtron se ato janë të përgjithshme, tepër të gjera dhe të mjegullta dhe se Aktakuza e Konfirmuar nuk jep faktet materiale në mbështetje të secilit pretendim.¹⁴⁶ Mbrojtja e Krasniqit konkretisht kërkon që këto pretendime të hiqen nga Aktakuza nëse ZPS-ja nuk mund të paraqesë të dhëna të mëtejshme dhe më të mira.¹⁴⁷ Ajo kërkon gjithashtu – së bashku me Mbrojtjen e Selimit – që të hiqen frazat “ndër të tjera”, “përfshirë” dhe “duke përfshirë” nga paragrafët 50(a), (d)-(f) dhe 51(a), (d) dhe (e) të Aktakuzës së Konfirmuar.¹⁴⁸ Gjithashtu, Mbrojtja e Krasniqit përsëri parashtron se Aktakuza e Konfirmuar nuk identifikon se çfarë pretendohet se ka bërë vetë z. Krasniqi, në dallim nga të akuzuarit e tjerë.¹⁴⁹

88. Së fundi, Mbrojtja e Selimit argumenton se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi edhe sepse mbështetet në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore sipas të cilit nuk është e nevojshme që kontributi në NKP të jetë kriminal në vetvete.¹⁵⁰ Ajo parashtron se vetëm një kontribut i konsiderueshëm apo një kontribut vetvetiu kriminal mund të sjellë përgjegjësi penale.¹⁵¹ Duke qenë se asnjë prej kontributeve të pretenduara në paragrafin 50 të Aktakuzës së Konfirmuar nuk e përmbushin këtë kusht, atëherë ato duhen hequr.¹⁵²

¹⁴⁴ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 22; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 29.

¹⁴⁵ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 21(a); Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 23.

¹⁴⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 32-33; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 23-27; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 53-60; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 9; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 24-26; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 30-37.

¹⁴⁷ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 26.

¹⁴⁸ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 26; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 20, 22.

¹⁴⁹ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 23(b).

¹⁵⁰ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 47-52.

¹⁵¹ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 51-52.

¹⁵² Mocioni Paraprak i Selimit, para. 52.

89. ZPS-ja përgjigjet se Aktakuza e Konfirmuar nuk ka mangësi sepse: (i) të akuzuarit pretendohet se kanë luajtur në vazhdimësi rol kyç dhe madhor në formulimin e qëllimit kriminal të përbashkët; (ii) ata nuk akuzohen se kanë kryer personalisht ndonjë prej krimeve të pretenduara dhe Aktakuza e Konfirmuar jep hollësi vetëm për disa shembuj të caktuar të përfshirjes së drejtpërdrejtë të të akuzuarve dhe/ose afërsisë me disa çështje, ngjarje dhe veprime penale të caktuara; (iii) përkimet e mundshme në format e pjesëmarrjes nuk krijojnë paqartësi; (iv) hollësitë përtej atyre që janë dhënë, janë çështje provash për t'u shqyrtuar në gjykim; (v) fjalët "përfshirë", "ndër të cilët/cilat", "ndër të tjerë/tjera" dhe "si" kanë për qëllim të japin hollësi të mëtejshme dhe nuk i krijojnë mundësinë ZPS-së ta zgjerojë çështjen e saj dhe të përfshijë forma të pjesëmarrjes që nuk i ka argumentuar në Aktakuzë; dhe (vi) ligji nuk parashikon lloje konkrete sjelljeje të cilat në vetvete nuk mund të përbëjnë kontribut në qëllimin kriminal të përbashkët.¹⁵³

(b) Konstatim

(i) *Pjesëmarrja personale në krimet për të cilat ngrihen akuzat*

90. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore akuzohen së pari për kryerjen e krimeve të pretenduara përmes pjesëmarrjes në një NKP.¹⁵⁴ Ata nuk akuzohen për kryerjen e drejtpërdrejtë të asnjë prej krimeve të pretenduara. Megjithatë, Aktakuza e Konfirmuar vërtet pretendon se të akuzuarit kanë dhënë kontribute për qëllimin e përbashkët të NKP-së, ndër të tjera duke marrë pjesë personalisht ose duke kontribuar në mënyra të tjera në krimet për të cilat ngrihen akuzat.¹⁵⁵ Pastaj, në të jepen shembuj të rasteve të

¹⁵³ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 17-20.

¹⁵⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 172.

¹⁵⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 40-47.

pjesëmarrjes personale të pretenduar. Që këta janë shembuj, del e qartë nga përdorimi i frazave “ndër të tjera edhe” dhe “si në rastet që diskutohen në vijim” në paragrafin 40 të Aktakuzës së Konfirmuar dhe kjo është pranuar shprehimisht edhe nga ZPS-ja.¹⁵⁶

91. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se raste të tilla, në të cilat të akuzuarit pretendohet se kanë marrë pjesë personalisht ose kanë dhënë përndryshe kontribut në krimet për të cilat ngrihen akuzat, duhet të paraqiten në mënyrë shteruese. Parashtrimi i ZPS-së, se kjo nuk është e nevojshme ngaqë të akuzuarit ngarkohen me përgjegjësi penale për NKP dhe nuk akuzohen për kryerje të drejtpërdrejtë, nuk është bindës. Aktakuza e Konfirmuar pretendon se pjesëmarrja personale dhe kontributi i të akuzuarve në krimet për të cilat ngrihen akuzat përbën kontribut për qëllimin e përbashkët të NKP-së. Pra, rastet e pjesëmarrjes personale janë fakte materiale që duhen paraqitur në Aktakuzën e Konfirmuar. Mosbërja e kësaj – qoftë pjesërisht apo tërësisht – përbën mosinformim (të plotë) të të akuzuarve për sjelljen prej së cilës pretendohet se rrjedh përgjegjësia e tyre penale. Kjo mund të dëmtojë mundësinë e tyre për t’u mbrojtur. Fakti se sjellja cilësohet ligjërisht si kontribut në qëllimin e përbashkët të NKP-së dhe jo si kryerje e drejtpërdrejtë nuk është i rëndësishëm. Të akuzuarit duhet t’i jepen gjithmonë informacione të hollësishme për sjelljen prej së cilës pretendohet se ka lindur përgjegjësia e tij penale dhe Aktakuza duhet t’i përmbajë të gjitha faktet mbi të cilat mbështeten akuzat e ngritura.¹⁵⁷

92. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi për aq sa nuk paraqet në mënyrë shteruese

¹⁵⁶ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 18.

¹⁵⁷ *Shih* Urdhri në Pajtim me Rregullën 86(4), para. 8-9, 15, 18; ICTY, [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 210 (ku thuhet se “të dhënat precize që duhen paraqitur në Aktakuzë si fakte materiale janë veprimet e të akuzuarve”); ICC, [Lubanga Appeal Judgment](#), para. 123 (ku thuhet se “të akuzuarit i duhet dhënë informacion i hollësishëm në lidhje me [...] sjelljen e pretenduar të tij ose të saj prej së cilës ka lindur përgjegjësia penale”).

rastet e pjesëmarrjes personale të të akuzuarve dhe kontributin në krimet për të cilat ngrihen akuzat. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëron ZPS-në të dorëzojë një version të korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar: (i) ku të zëvendësojë frazën “ndër të tjera edhe përmes” në paragrafin 40 të Aktakuzës së Konfirmuar me fjalën “përmes”; dhe (ii) të zëvendësojë frazën “si në rastet që diskutohen në vijim” me frazën “siç diskutohet në vijim”.¹⁵⁸ Nëse ZPS-ja dëshiron të paraqesë raste të tjera të pjesëmarrjes personale të të akuzuarve në krimet për të cilat ngrihen akuzat, do të duhet të kërkojë ndryshim të Aktakuzës së Konfirmuar.¹⁵⁹

93. Gjykatësi i Procedurës Paraprake u kthehet tani parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Krasniqit se datat, vendet, identitetet e viktimave dhe veprimet e të akuzuarve nuk janë dhënë me konkretësi të mjaftueshme.

94. Sa u takon datave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, kur nuk mund të përcaktohet një datë precize, mund të jepet një varg i arsyeshëm datash.¹⁶⁰ Paragrafët 41-47 të Aktakuzës së Konfirmuar u referohen ose kornizave kohore konkrete (të tilla si “korrik 1998”,¹⁶¹ “në fund të korrikut 1998”, “tetor 1998”, [REDAKTUAR], ose data të përafërta (“më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth [REDAKTUAR]”). Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se paragrafët 41-47 duhen lexuar së bashku me atë pjesë të Aktakuzës së Konfirmuar që ka të

¹⁵⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake sqaron se fraza “ndër të tjera” në paragrafin 44, rreshti i nëntë, mund të qëndrojë sepse ka për qëllim të japë hollësi të tjera lidhur me sjelljen (“i morën [REDAKTUAR] në pyetje”) që është paraqitur më parë me konkretësi të mjaftueshme; *shih më poshtë për më tepër* para. 99.

¹⁵⁹ Vendimi i Apelit në “Gucati dhe Haradinaj”, para. 87.

¹⁶⁰ *Shih më lart* para. 33.

¹⁶¹ Kjo kornizë kohore bëhet edhe më konkrete përmes referimit në “menjëherë pas sulmeve të njësiteve të UÇK-së mbi Rahovecin”; Aktakuza e Konfirmuar, para. 42.

bëjë me krimet për të cilat ngrihen akuzat dhe Listat A-C.¹⁶² Këto pjesë ua shtojnë konkretësinë akuzave të ngritura përmes dhënies së datave të tjera të përafërta.¹⁶³

95. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në dy raste, Aktakuza e Konfirmuar mbetet e paqartë lidhur me kornizat kohore përkatëse:

- a) në paragrafin 43, ZPS-ja pretendon se “në një numër rastesh”, z. Thaçi dhe z. Selimi ndërmorën hapa për të frikësuar dhe për të vendosur pushtetin e tyre mbi njësitet që kishin lidhje me Lidhjen Demokratike të Kosovës (“LDK”). Formulimi “në një numër rastesh” ndiqet nga një shembull i vetëm i përshkruar me kohë dhe vend, përpara të cilit është vendosur fraza “përfshirë edhe”. Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ky formulim nuk i informon në mënyrë adekuate të akuzuarit për “rastet” në të cilat pretendohet se kanë ndërmarrë hapa për të frikësuar dhe vendosur pushtetin e tyre mbi njësitet e lidhura me LDK-në. Rrjedhimisht, urdhërohet ZPS-ja që ose: (i) të japë më shumë konkretësi për rastet në të cilat pretendohet se të akuzuarit kanë ndërmarrë hapa të tillë; ose (ii) të heqë fjalët “Në një numër rastesh, përfshirë edhe” nga paragrafi 43 i Aktakuzës së Konfirmuar;¹⁶⁴
- b) në paragrafin 47, ZPS-ja pretendon se zotërinjtë Veseli, Selimi dhe Krasniqi “u përfshinë në aspekte të ndryshme të transferimit, ndalimit dhe/ose lirimit

¹⁶² *Shih*, për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 65, 73, 101, 107-108, 110.

¹⁶³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse disa informacione të caktuara në paragrafët 41, 43 dhe 47 të Aktakuzës së Konfirmuar, si edhe në pjesën që lidhet me krimet për të cilat ngrihen akuzat dhe në Lista, janë aktualisht të redaktuara për Mbrojtjen në përputhje me masat mbrojtëse të miratuara në procedurë gjyqësore, këto redaktime nuk e cenojnë konkretësinë e Aktakuzës së Konfirmuar sepse çdo e dhënë e tillë e redaktuar do t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes në kohën e duhur.

¹⁶⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se një frazë me kuptimin “përfshirë edhe” është përdorur edhe kur përmenden “njësitet që kishin lidhje me LDK-në, ndër të cilat edhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës të lidhura me qeverinë në mërgim” (theksimi i shtuar). Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “ndër të tjera” në këtë kontekst synon të japë më shumë konkretësi për një kategori të përcaktuar (“njësitet që kishin lidhje me LDK-në”). Si e tillë, ajo nuk krijon paqartësi dhe as i jep mundësi ZPS-së ta zgjerojë çështjen e saj.

të të ndaluarve që mbaheshin në një qendër ndalimi afër Kleçkës” gjatë vitit 1999. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, edhe kur lexohet së bashku me atë pjesë të Aktakuzës së Konfirmuar që ka të bëjë me krimet për të cilat ngrihen akuzat dhe me Listën A, nga kjo të akuzuarit nuk marrin informacion adekuat për kornizën kohore përkatëse të përfshirjes së tyre të pretenduar. Rrjedhimisht, urdhërohet ZPS-ja që ose: (i) të japë më shumë konkretësi në Aktakuzën e Konfirmuar lidhur me kornizën kohore përkatëse; ose (ii) ta heqë fjalinë “Në 1999, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI u përfshinë në aspekte të ndryshme të transferimit, ndalimit dhe/ose lirimit të të ndaluarve që mbaheshin në një qendër ndalimi afër Kleçkës” nga paragrafi 47 i Aktakuzës së Konfirmuar. E njëjta vlen edhe për paragrafin 75 të Aktakuzës së Konfirmuar.

96. Sa u takon vendeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paragrafët 41-47 të Aktakuzës së Konfirmuar u referohen vendndodhjeve konkrete ose të përafërta (të tilla si “Rahovecin dhe fshatrat përreth”, “në Rahovec, rrethina”, “ish-stacionin e policisë në Malishevë”, [REDAKTUAR], “Jabllanicë”, [REDAKTUAR], “një qendër ndalimi afër Kleçkës”).¹⁶⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mendon se formulime të tilla si “Rahovecin dhe fshatrat përreth” apo “në Rahovec, rrethina” kanë mangësi. Kufijtë precizë të zonës në fjalë mund të mos jenë të përcaktuar qartë dhe janë çështje për të cilat do të vendoset në gjykim. ZPS-së nuk i kërkohet në këtë fazë të rendisë të gjitha “fshatrat përreth” përkatëse.

97. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit ka kundërshtim edhe për formulimin “në vende të tjera” në paragrafin 42 të Aktakuzës së

¹⁶⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 42-47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse disa informacione të caktuara që përmbajnë paragrafët 41, 43 dhe 47 të Aktakuzës së Konfirmuar janë aktualisht të redaktuara për Mbrojtjen në përputhje me masat mbrojtëse të miratuara në procedurë gjyqësore, këto redaktime nuk e cenojnë konkretësinë e Aktakuzës së Konfirmuar sepse çdo e dhënë e tillë e redaktuar do t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes në kohën e duhur.

Konfirmuar,¹⁶⁶ ku përmenden disa të ndaluar që pretendohet se janë rrëmbyer “në Rahovec, rrethina, dhe në vende të tjera” (theksimi i shtuar). Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mendon se ky formulim krijon ndonjë paqartësi sepse është identifikuar konkretisht vendi ku pretendohet se janë shpënë të ndaluarit (“ish-stacionin e policisë në Malishevë”).

98. Sa u takon viktimave të pretenduara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paragrafët 41-47 të Aktakuzës së Konfirmuar i identifikojnë duke përmendur: (i) periudhën kohore dhe vendin e rrëmbimit ose arrestimit të pretenduar dhe vendin ku pretendohet se janë transferuar (p.sh., “rrëmbyer në Rahovec [dhe] rrethina” në korrik 1998 dhe “transferimit [...] në ish-stacionin e policisë në Malishevë”; pretendohet se janë arrestuar në [REDAKTUAR], më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth [REDAKTUAR], dhe janë transferuar në [REDAKTUAR]); (ii) kombësinë (p.sh., “civilë serbë”, [REDAKTUAR]); (iii) numrin (p.sh., [REDAKTUAR]); dhe/ose (iv) profesionin (p.sh., [REDAKTUAR]). Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se paragrafët 41-47 duhen lexuar së bashku me atë pjesë të Aktakuzës së Konfirmuar që ka të bëjë me krimet për të cilat ngrihen akuzat dhe me Listën A, ku jepen të dhëna të tjera të ngjashme dhe identifikohen me emër disa prej viktimave.¹⁶⁷

99. Sa u takon veprimeve të pretenduara të të akuzuarve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ato paraqiten të përmbledhura dhe me konkretësi të mjaftueshme (p.sh., [REDAKTUAR], “u përfshinë në aspekte të ndryshme të transferimit, ndalimit dhe/ose lirimit të të ndaluarve”).¹⁶⁸ Këto veprime të

¹⁶⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 33.

¹⁶⁷ *Shih*, për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 65, 107-108, 110. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse disa informacione të caktuara që përmbajnë paragrafët 41, 43 dhe 47 të Aktakuzës së Konfirmuar, si edhe pjesa në lidhje me krimet për të cilat janë ngritur akuzat dhe Listat, janë tani për tani të redaktuara për Mbrojtjen, në përputhje me masat mbrojtëse të miratuara në procedurë gjyqësore, këto redaktime nuk e cenojnë konkretësinë e Aktakuzës së Konfirmuar sepse çdo e dhënë e tillë e redaktuar do t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes në kohën e duhur.

¹⁶⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 42-47.

pretenduar nuk kanë nevojë të paraqiten me më shumë hollësi. Ajo që ka rëndësi është që të akuzuarit të informohen për sjelljen prej së cilës pretendohet se ka lindur përgjegjësia e tyre penale. Hollësitë e tjera krahas atyre që janë dhënë janë çështje për të cilat do të vendoset në gjykim.

100. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kthehet parashtrimit të Mbrojtjes së Krasniqit se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi sepse sjellja e z. Krasniqi nuk paraqitet veçmas nga sjellja e të akuzuarve të tjerë.¹⁶⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mendon se përmendja e disa të akuzuarve së bashku e bën jokonkrete apo me mangësi Aktakuzën e Konfirmuar, duke pasur parasysh se të akuzuarit pretendohet se kanë vepruar në bazë të një NKP-je. Sipas rastit, ajo përshkruan me hollësi të mjaftueshme pjesëmarrjen e tyre personale në krimet për të cilat ngrihen akuzat, duke u dhënë atyre mundësi të identifikojnë ngjarjet ose incidentet në fjalë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e kupton se, sa herë që disa të akuzuar përmenden së bashku, sjellja e pretenduar vlen për të gjithë të akuzuarit e përmendur.

101. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se ZPS-së nuk i lejohej të pretendojë të njëjtin lloj/të njëjtat lloje sjelljeje për disa të akuzuar, nëse kjo sjellje nuk vlen për të gjithë ata. Një praktikë e tillë nuk e informon qartë të akuzuarin lidhur me llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij. Kjo rrezikon ta dëmtojë edhe përgatitjen e tij, duke qenë se i kërkon mbrojtjes të caktojë kohë dhe burime për të hetuar dhe prapësuar pretendime të cilat në të vërtetë nuk kanë lidhje me të. Rrjedhimisht, sa herë që për disa të akuzuar njëkohësisht pretendohen lloje të ndryshme sjelljeje dhe nëse një sjellje e tillë nuk ka të bëjë me të gjithë ata, ZPS-ja urdhërohet të japë më shumë konkretësi se cila sjellje pretendohet për cilin të akuzuar.

¹⁶⁹ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 21(a); Kundërpërgjegjësia e Krasniqit, para. 23.

102. Mbështetur në sa më lart dhe duke mbajtur parasysh kushtin e përshkruar në paragrafët 92 dhe 95 më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pjesëmarrja e pretenduar personale e të akuzuarve në krimet për të cilat ngrihen akuzat paraqitet me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme në Aktakuzën e Konfirmuar.

(ii) Format e tjera të kontributit

103. Duke iu kthyer kontributeve të pretenduara të të akuzuarve në qëllimin e përbashkët, të cilat nuk përfshihen në pjesëmarrjen e tyre të pretenduar personale në krimet për të cilat ngrihen akuzat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren fillimisht se paragrafët 48-51 të Aktakuzës së Konfirmuar përshkruajnë në mënyrë të përmbledhur por të plotë format e ndryshme me të cilat pretendohet se të akuzuarit kanë kontribuar në arritjen e qëllimit të përbashkët. Ajo që ka rëndësi është se kontributet e pretenduara paraqiten në mënyrë shteruese dhe se Aktakuza e Konfirmuar nuk lë vend për paqartësi në këtë aspekt.

104. Së dyti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se të akuzuarit pretendohet se kanë qenë zyrtarë të lartë të UÇK-së dhe QPK-së dhe se kishin një qëllim të përbashkët me anëtarët e tjerë të NKP-së.¹⁷⁰ Natyra e akuzave të ngritura në këtë çështje, shtrirja e gjerë e krimeve të pretenduara dhe periudha e zgjatur në të cilën u kryen ato, si dhe përfshirja e pretenduar e individëve të tjerë në kryerjen e krimeve të pretenduara, e bëjnë të përealizueshme që Aktakuza e Konfirmuar të rendisë të gjitha të dhënat konkrete lidhur me kontributet e pretenduara të të akuzuarve, siç e kërkon Mbrojtja.¹⁷¹ Hollësi të tilla mund të jepen në Përmbledhjen Sipas Rregullës 86(3)(b) dhe në provat e paraqitura. Megjithëse ZPS-ja nuk mund të paraqesë në Përmbledhjen sipas Rregullës 86(3)(b) apo në prova forma të tjera

¹⁷⁰ Aktakuza e Konfirmuar, para. 2, 5, 8, 11.

¹⁷¹ *Shih* Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 33; Mocioni i Mbrojtjes së Krasniqit, para. 23(b), 26.

shtesë kontributi të papërfshira në Aktakuzën e Konfirmuar, ky material i jep Mbrojtjes të dhëna të tjera bazë dhe i ndihmon të akuzuarit të përgatitin mbrojtjen e tyre. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se mënyra me të cilën i paraqet ZPS-ja kontributet e pretenduara të të akuzuarve në qëllimin e përbashkët është në përputhje me praktikën e gjykatave penale ndërkombëtare.¹⁷²

105. Së treti, në lidhje me përdorimin e “ndër të tjera”, “përfshirë edhe” apo “duke përfshirë edhe” në paragrafët 48-51 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ky formulim përdoret për të dhënë shembuj në lidhje me format e kontributit tashmë të paraqitura shprehimisht. Në këtë kontekst, frazat “ndër të tjera”, “përfshirë edhe” dhe “duke përfshirë edhe” nuk përdoren si një formulim i hapur dhe nuk i japin mundësi ZPS-së ta zgjerojë çështjen e saj. Pra Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se frazat “ndër të tjera”, “përfshirë edhe” apo “duke përfshirë edhe” në paragrafët 48-51 të Aktakuzës së Konfirmuar mund të qëndrojnë.¹⁷³

106. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në paragrafët 48-51 të Aktakuzës së Konfirmuar thuhet se të akuzuarit kontribuan në qëllimin e përbashkët “përmes një ose më shumë prej mënyrave” të renditura aty. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e kupton se kjo do të thotë se mbase jo të gjitha format e kontributit të renditura aty vlejné për të gjithë të akuzuarit apo lidhen me të gjithë ata. Aty ku është kështu dhe për arsyet e shpjeguara në paragrafin 101 më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të përshkruajë me qartësi dhe konkretësi se cilat forma konkrete kontributi pretendohen për cilin të akuzuar.

107. Mbështetur në sa më lart dhe duke mbajtur parasysh kushtin e vendosur në paragrafin 106 më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kontributet

¹⁷² Shih ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-PT, [Third Amended Indictment](#), 27 February 2009, para. 14; *Prosecutor v. Krajišnik and Plavšić*, IT-00-39 & 40-PT, [Amended Consolidated Indictment](#), 7 March 2002, para. 8; *Prosecutor v. Gotovina et al.*, IT-06-90-T, [Amended Joinder Indictment](#), 12 March 2008, para. 17-20.

¹⁷³ I njëjti parim vlen për paragrafin 36 të Aktakuzës së Konfirmuar.

e pretenduara të të akuzuarve në qëllimin e përbashkët paraqiten me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme në Aktakuzën e Konfirmuar.

(iii) Mangësia e pretenduar për shkak të kriminalizimit të veprimit legjitim

108. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kthehet tani kundërshtimit të Mbrojtjes së Selimit se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi ngaqë mbështetet në një interpretim të gabuar të ligjit, sipas të cilit nuk është nevoja që kontributi në NKP të jetë kriminal në vetvete.¹⁷⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo është një pikë juridike të cilën Mbrojtja mund ta debatojë në gjykim, nëse dëshiron. Gjithashtu, pyetja që lind prej kësaj – nëse mund të merret parasysh gjatë përcaktimit të përgjegjësisë penale të të akuzuarve një sjellje e cila në dukje nuk është kriminale – është e parakohshme. Gjithsesi, përfshirja në Aktakuzën e Konfirmuar e disa formave të caktuara të sjelljes së pretenduar jokriminale, që ka për qëllim të informojë të akuzuarit për provat e ZPS-së, nuk e bëjnë atë me mangësi. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rrëzon kundërshtimin e Mbrojtjes së Selimit.

D. ARGUMENTIMI I NDIHMËS DHE INKURAJIMIT

(a) Parashtrimet

109. Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Krasniqit dhe Mbrojtja e Selimit parashtrojnë se argumentimi i ndihmës dhe inkurajimit është i mangët sepse është e paqartë se në cilat veprime dhe mosveprime të të akuzuarve mbështetet për të përcaktuar

¹⁷⁴ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 47-52.

përgjegjësine e tyre penale.¹⁷⁵ Për aq sa veprimet dhe mosveprimet janë të njëjta me ato që përbëjnë bazën mbi të cilën mbështetet vërtetimi i përgjegjësisë për NKP, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Krasniqit shtojnë se: (i) siç është parashtruar më parë, këto pretendime janë palejueshmërisht të mjegullta dhe të përgjithshme; (ii) Aktakuza e Konfirmuar nuk përcakton se si veprimet dhe mosveprimet e pretenduara patën ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë; dhe (iii) nuk arrin të argumentojë se si të akuzuarit ishin të vetëdijshëm për gjasën e kryerjes së krimeve.¹⁷⁶

110. ZPS-ja përgjigjet se Aktakuza e Konfirmuar nuk ka mangësi sepse: (i) në të thuhet qartë se veprimet dhe mosveprimet në rastin e ndihmës dhe inkurajimit janë të njëjta me ato që paraqiten në rastin e përgjegjësisë penale për NKP; (ii) veprimet dhe praktika e sjelljes përshkruhen me hollësi të mjaftueshme; (iii) ndikimi i një sjelljeje të tillë në çdo krim të veçantë do të vendoset në bazë të provave; dhe (iv) synimi kriminal pretendohet shprehimisht, siç pretendohen edhe faktet përmes të cilave mund të deduktohet gjendja mendore e të akuzuarve.¹⁷⁷

(b) Konstatim

111. Së pari, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar thotë qartë se “veprime[t] dhe mosveprime[t]” e paraqitura lidhur me përgjegjësine për NKP përbëjnë bazën edhe për ndihmën dhe inkurajimin.¹⁷⁸ Së dyti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar më parë se këto veprime apo sjellje, me kushtet e vëna më lart, paraqiten me konkretësi të mjaftueshme.¹⁷⁹ Kjo

¹⁷⁵ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 36; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 30(a)-(b); Mocioni Paraprak i Selimit, para. 25, 29 e në vijim.

¹⁷⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 36-39; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 30(b)-(f).

¹⁷⁷ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 21-23.

¹⁷⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 52.

¹⁷⁹ *Shih më lart* para. 90-102.

çështje nuk do të trajtohet më tej. Së treti, nëse veprimet apo mosveprimet e pretenduara kishin apo jo ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve të përfshira në Aktakuzë mbetet për t'u vendosur në gjykim. Së fundi, në lidhje me synimin kriminal, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar argumenton vetë gjendjen mendore. Pra, në këtë rast, faktet përmes të cilave do të vërtetohet gjendja mendore janë çështje provash.¹⁸⁰

112. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se forma e përgjegjësisë e nxitjes dhe inkurajimit paraqitet me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme në Aktakuzën e Konfirmuar dhe rrëzon kundërshtimin e Mbrojtjes së Thaçit, Mbrojtjes së Krasniqit dhe Mbrojtjes së Selimit në këtë aspekt.

E. ARGUMENTIMI I PËRGJEGJËSISË EPRORE

(a) Parashtrimet

113. Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Krasniqit dhe Mbrojtja e Selimit parashtrojnë se argumentimi i përgjegjësisë eprore ka mangësi sepse Aktakuza e Konfirmuar nuk identifikon në mënyrë të qartë dhe precize: (i) faktet materiale prej të cilave arrihet në përfundimin se ekzistonte raporti epror-vartës; (ii) identitetin e vartësve; (iii) sjelljen kriminale të vartësve dhe format përkatëse të përgjegjësisë; (iv) sjelljen e të akuzuarve përmes së cilës konstatohet se dinin ose kishin arsye të dinin se krimet ishin në prag të kryerjes ose ishin kryer prej vartësve të tyre; dhe (v) sjelljen e të akuzuarve në bazë të së cilës pretendohet se ata nuk morën masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar aktet ose nuk i ndëshkuan kryesit e krimeve.¹⁸¹

¹⁸⁰ *Shih më lart* para. 36.

¹⁸¹ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 40-48; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 32-40; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 65-77; Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 11-12; Kundërpërgjigja e Selimit, para. 19-22.

114. ZPS-ja përgjigjet se Aktakuza e Konfirmuar nuk ka mangësi sepse: (i) të akuzuarit pretendohet se kanë qenë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm dhe ndër zyrtarët më të lartë në UÇK dhe/ose QPK, që është e mjaftueshme për të parashtruar argumentin për pozitat e tyre eprorë; (ii) Aktakuza e Konfirmuar identifikon qartë vartësit e pretenduar duke iu referuar anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së të përcaktuara më parë; (iii) pretendimet lidhur me sjelljen kriminale të vartësve duhen lexuar duke mbajtur parasysh faktet materiale në të cilat mbështeten krimet e përfshira në Aktakuzë; (iv) synimi kriminal është argumentuar shprehimisht; dhe (v) mosmarrja e masave të nevojshme dhe të arsyeshme nga të akuzuarit për të parandaluar kryerjen e krimeve të përfshira në Aktakuzë apo për t'i ndëshkuar kryesit e krimeve është në vetvete fakti material që duhet paraqitur dhe nuk nevojiten hollësi të tjera.¹⁸² ZPS-ja shton se Aktakuza e Konfirmuar shkon përtej kërkesave minimale sepse paraqet fakte që dëshmojnë kontrollin efektiv të të akuzuarve, fakte përmes të cilave mund të vërtetohet drejtpërdrejt ose tërthorazi gjendja e tyre mendore dhe disa veprime dhe mosveprime të caktuara që dëshmojnë mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme prej tyre.¹⁸³

(b) Konstatim

(i) Marrëdhënia epror-vartës dhe identiteti i vartësve

115. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar pretendon se të akuzuarit ishin anëtarë të Shtabit Qendror të UÇK-së dhe të QPK-së. Pretendohet se ata i mbanin këto poste në momente të ndryshme gjatë periudhës që ka lidhje me Aktakuzën e Konfirmuar, të cilat dëshmojnë pozitat e tyre si eprorë:

¹⁸² Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 24-33.

¹⁸³ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 26, 30, 33.

- a. Z. Thaçi: shef i Drejtorisë Politike dhe asaj të Informimit të UÇK-së, Kryekomandant i UÇK-së dhe Kryeministër i QPK-së;
- b. Z. Veseli: anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së, shef i shërbimit të zbulimit të UÇK-së, shef i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe Ministër i Shërbimit Informativ në QPK;
- c. Z. Selimi: shef i Drejtorisë Operative të UÇK-së, Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së dhe Ministër i Rendit Publik/Ministër i Punëve të Brendshme në QPK;
- d. Z. Krasniqi: anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së, zëdhënës zyrtar i UÇK-së, zëvendëskomandant i UÇK-së dhe zëdhënës i QPK-së.¹⁸⁴

116. Aktakuza e Konfirmuar paraqet më tej se, në këto cilësi dhe në bazë të pushtetit të tyre *de facto*, të akuzuarit kishin kontroll efektiv mbi anëtarët dhe instrumentet e NKP-së që kryen krimet e paraqitura në Aktakuzë.¹⁸⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se baza për përgjegjësinë e pretenduar eprorë të të akuzuarve është paraqitur mjaftueshëm në Aktakuzën e Konfirmuar dhe nuk konstaton asnjë mangësi në këtë aspekt.

117. Duke vënë re se Mbrojtja e Krasniqit kundërshton pretendimin se UÇK-ja kishte një shkallë të mjaftueshme organizimi dhe linja autoriteti dhe komunikimi për të justifikuar konstatimin e përgjegjësisë komanduese,¹⁸⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nënvizon se kjo mbetet të konstatohet në gjykim në bazë të provave. Nëse Mbrojtja e Krasniqit kundërshton ekzistencën e një marrëdhënieje epror-vartës, ajo mund ta debatojë këtë para Trupit Gjykses. Në funksion të informimit të të akuzuarve për akuzat e ngritura, faktet që mbështetin marrëdhënien e pretenduar epror-vartës janë paraqitur mjaftueshëm.

¹⁸⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 2, 5, 8, 11.

¹⁸⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 53.

¹⁸⁶ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 34.

118. Për t'iu kthyer identiteteve të vartësve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar i identifikon vartësit e pretenduar se ishin anëtarë dhe instrumente të NKP-së.¹⁸⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar më parë se anëtarët dhe instrumentet e NKP-së janë identifikuar mjaftueshëm.¹⁸⁸ Për të njëjtat arsye dhe duke pasur parasysh parimet e përfshira në paragrafin 38 më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vartësit e pretenduar janë identifikuar mjaftueshëm.

(ii) *Sjellja e vartësve dhe format përkatëse të përgjegjësisë*

119. Duke vënë re parashtrimin e Mbrojtjes së Thaçit se argumentimi i sjelljes kriminale të vartësve është paraqitur me mangësi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se pjesa e Aktakuzës së Konfirmuar për përgjegjësinë eprore duhet lexuar së bashku me pjesën ku parashtrohen krimet për të cilat ngrihen akuzat.¹⁸⁹ Sa i takon parashtrimin të Mbrojtjes së Selimit se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi ngaqë nuk përcakton konkretisht format e përgjegjësisë të zbatueshme për krimet e përfshira në Aktakuzë,¹⁹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, megjithëse krimet e kryera nga vartësit janë fakte materiale për t'u paraqitur në Aktakuzë, format përkatëse të përgjegjësisë nuk janë të tilla.¹⁹¹ Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Selimit në këtë aspekt.

¹⁸⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 53.

¹⁸⁸ *Shih më lart* para. 80, 84.

¹⁸⁹ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 43.

¹⁹⁰ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 67.

¹⁹¹ *Për ngjashmëri*, ICTY, [Perišić Decision](#), para. 31.

(iii) *Elementi mendor*

120. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se ZPS-ja mund të argumentojë ose vetë gjendjen mendore, e në këtë rast faktet përmes të cilave vërtetohet ajo janë çështje provash, ose mund të paraqesë faktet prej të cilave mund të nxirret deduksion për gjendjen mendore.¹⁹²

121. Aktakuza e Konfirmuar pretendon se të akuzuarit dinin ose kishin arsye të dinin, përmes burimeve të shumta, se persona nën kontrollin efektiv të tyre ishin në prag të kryerjes ose kishin kryer krime.¹⁹³ Më tej, ajo paraqet, në mënyrë jo shteruese, disa fakte të caktuara prej të cilave mund të deduktohet gjendja mendore të të akuzuarve në lidhje me: (i) përfshirjen e tyre në përgatitjen, projektimin dhe/ose kryerjen e krimeve; (ii) praninë e tyre në vendet ku u kryen krimet; (iii) marrjen prej tyre të informacionit për kryerjen e krimeve të tilla; dhe/ose (iv) shikimin personalisht prej tyre të provave të kryerjes së këtyre krimeve.¹⁹⁴

122. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, përmes argumentimit të vetë gjendjes mendore, Aktakuza e Konfirmuar i informon mjaftueshëm të akuzuarit për gjendjen e pretenduar mendore të tyre. Nga Aktakuza e Konfirmuar nuk kërkohet të paraqesë më tej faktet prej të cilave mund të deduktohet gjendja mendore. Nëse këto fakte janë të përgjithshme dhe të mjegullta – siç parashtrohet Mbrojtja¹⁹⁵ – kjo është e parëndësishme. Kjo është diçka që do të vlerësohet në gjykim. Po kështu, përdorimi i frazës së hapur “ndër të tjera” në paragrafin 54 të Aktakuzës së Konfirmuar – për të cilin Mbrojtja ka kundërshtim¹⁹⁶ – nuk do të

¹⁹² *Shih më lart* para. 36-38.

¹⁹³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 54.

¹⁹⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 54.

¹⁹⁵ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 44; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 38; Mocioni Paraprak i Selimit, para. 68-70.

¹⁹⁶ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 38(c); Mocioni Paraprak i Selimit, para. 68; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 19, 21.

thotë se Aktakuza e Konfirmuar ka mangësi. Përkundrazi, kjo frazë përdoret për të ofruar më shumë konkretësi, duke paraqitur disa fakte të caktuara prej të cilave mund të deduktohet gjendja mendore.

123. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i rrëzon kundërshtimet e Mbrojtjes në këtë aspekt.

(iv) Sjellja sipas së cilës mund të konstatohet se të akuzuarit nuk morën masa të nevojshme dhe të arsyeshme

124. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në shumë raste do të mjaftonte të argumentohej se të akuzuarit nuk kanë marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar ose ndëshkuar kryerjen e krimeve.¹⁹⁷

125. Aktakuza e Konfirmuar pretendon se të akuzuarit nuk morën masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë dhe/ose nuk i ndëshkuan kryesit e këtyre krimeve.¹⁹⁸ Më tej ajo parashtron një listë joshteruese të masave që pretendohet se nuk morën të akuzuarit: (i) nisja e hetimeve të mirëfillta ose të mjaftueshme, ose marrja e masave të tjera të mirëfillta dhe të mjaftueshme; (ii) raportimi i kryerjes, ose kryerjes së mundshme, të krimeve; (iii) masa disiplinore, përjashtimi ose ulja në përgjegjësi; (iv) dhënia e urdhrave për të ndaluar ose për t'i dhënë fund kryerjes së krimeve; dhe/ose (iv) marrja e masave të tjera të mjaftueshme, si trajnim i duhur, rregulla dhe procedura, për të siguruar moskryerjen e krimeve.¹⁹⁹

126. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, duke argumentuar se të akuzuarit nuk morën masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar kryerjen e krimeve të përfshira në Aktakuzë dhe/ose për të ndëshkuar kryesit e

¹⁹⁷ *Shih më lart* para. 38.

¹⁹⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 55.

¹⁹⁹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 55.

tyre, Aktakuza e Konfirmuar i informon mjaftueshëm të akuzuarit për mosmarrjen e pretenduar të masave të nevojshme dhe të arsyeshme nga ana e tyre. Nga Aktakuza e Konfirmuar nuk kërkohet të paraqesë hollësi konkrete të cilat pretendohet se dëshmojnë mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme nga ana e tyre. Këto janë çështje provash për të cilat do të vendoset në gjykim.²⁰⁰ Fakti se Aktakuza e Konfirmuar përdor frazën “ndër të tjera edhe” në paragrafin 55(e) – për të cilën ka kundërshtim Mbrojtja e Selimit²⁰¹ – nuk e bën atë me mangësi, sepse ky formulim përdoret për të ofruar më shumë konkretësi. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rrëzon këtë kundërshtim.

F. KUNDËRSHTIME NDAJ PARAQITJES SË KRIMEVE TË VEÇANTA NË AKTAKUZË

1. Të përgjithshme

127. Që në fillim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në përcaktimin e shkallës së konkretësisë që nevojitet në paraqitjen e krimeve të veçanta duhen mbajtur parasysh rrethanat e kësaj çështjeje gjyqësore dhe natyra dhe shkalla e krimeve dhe format e përgjegjësisë penale për të cilat ngrihen akuzat. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se nuk pretendohet se të akuzuarit kanë kryer fizikisht vetë ndonjë prej krimeve të përfshira në Aktakuzë. Përkundrazi, pretendohet se ata i kanë kryer këto krime përmes pjesëmarrjes në një NKP dhe/ose si ndihmues dhe inkurajues.²⁰² Krahas kësaj, ose si alternativë, pretendohet se të akuzuarit janë përgjegjës si eprorë për krimet e kryera nga vartësit e tyre.²⁰³

²⁰⁰ SCSL, *Prosecutor v. Sesay et al.*, SCSL-04-15-A, Appeals Chamber, *Judgement*, 26 October 2009, para. 76.

²⁰¹ Mocioni Paraprak i Selimit, para. 76.

²⁰² Aktakuza e Konfirmuar, para. 32-52, 172-173.

²⁰³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 53-55, 172-173.

128. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se krimet për të cilat ngrihen akuzat pretendohet se ishin të përhapura gjerësisht, të vijueshme dhe të përsëritura dhe se janë kryer: (i) pas arrestimeve dhe rrëmbimeve dhe në, ose në lidhje me, 42 qendra ndalimi në një sërë vendesh të përmendura me emër në 16 komuna të Kosovës dhe në dy rrethe të Shqipërisë Veriore; (ii) gjatë një periudhe kohore që zgjati mbi 19 muaj; dhe (iii) kundër qindra viktimave.²⁰⁴

2. Elementet e përgjithshme të krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit

(a) Parashtrimet

129. Mbrojtja e Thaçit parashtron se ka mangësi në paraqitjen e elementeve të përgjithshme të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në Aktakuzën e Konfirmuar.²⁰⁵ Sa u takon elementeve të përgjithshme të krimeve të luftës, ajo argumenton se nuk mund të thuhet që viktimat e tyre, të përkufizuara si “kundërshtarë”, merrnin pjesë aktive në veprime luftarake, duke pasur parasysh se ZPS-ja specifikon se ky term përfshin edhe ata që ishin “bashkëpunëtorë” ose “të lidhur” me forca të Republikës Federale të Jugosllavisë (“RFJ”).²⁰⁶ Mbrojtja e Thaçit arrin në përfundimin se nuk është përmbushur kriteri i lidhjes së krimeve të luftës me konfliktin e armatosur.²⁰⁷

130. Sa u takon elementeve të përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit, Mbrojtja e Thaçit parashtron se krimet për të cilat ngrihen akuzat nuk janë kundër një “popullate civile” siç e kërkon neni 13 i Ligjit dhe e drejta zakonore ndërkombëtare, por kundër një nënbashkësie civilësh të pretenduar,

²⁰⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 16, 19, 37, 57-59, 94-96, 135-136, 171. *Shih edhe* Aktakuza e Konfirmuar, para. 57-171, Listat A-C. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se: (i) numri minimal i përafërt i viktimave të pretenduara të përmendura në Listën A është 430; (ii) numri i viktimave të përmendura në Listën B është 98; dhe (iii) numri i viktimave të përmendura në Listën C është 18.

²⁰⁵ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 49-57.

²⁰⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 54-55.

²⁰⁷ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 55.

“kundërshtarëve”.²⁰⁸ Pretendohet se: (i) Aktakuza e Konfirmuar ose e përfshin (paragrafi 16) ose nuk e përmend (paragrafi 17) termin “civil”; (ii) “kundërshtarët” janë një grup civilësh të përzgjedhur në mënyrë rastësore; dhe (iii) është e vështirë të kuptohet se si mund të thuhet që ishte kundër popullatës civile një sulm i cili drejtohej pjesërisht kundër atyre punonin me forcat e RFJ-së.²⁰⁹ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit parashtron se një aspekt i përkufizimit të “kundërshtarëve”, që është përmendja e “kombësive të tjera” në paragrafin 32(b) të Aktakuzës së Konfirmuar është palejueshmërisht i mjegullt, duke qenë se nuk përcakton se cilat kombësi të tjera përfshin.²¹⁰

131. ZPS-ja përgjigjet se: (i) siç paraqet në Aktakuzën e Konfirmuar dhe siç pranohet në Vendimin e Konfirmimit, termi “kundërshtarë” përfshin persona “të punësuar ose [...] në ushtrinë ose policinë serbe/jugosllave”, të cilët, gjithsesi, sipas konstatimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Konfirmimit, nuk merrnin pjesë aktive në veprime luftarake në kohën e kryerjes së krimeve dhe, për rrjedhojë, përfshihen në popullatën civile;²¹¹ dhe (ii) kundërshtimet e Mbrojtjes për sa i përket mjaftueshmërisë juridike dhe faktike të konstatimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me popullatën civile dhe me statusin e viktimave, nuk janë çështje që ngrihen në një mocion paraprak që ka të bëjë me formën e Aktakuzës, por çështje që zgjidhen në gjykim.²¹² Më tej, ajo argumenton se “kundërshtarët” e vënë në shënjestër janë përkufizuar mjaftueshëm sipas grupeve dhe përkatësisë, dhe frazat “ndër të cilët” dhe “të kombësive të tjera” në këtë kontekst nuk ndikojnë në qartësinë e përshkrimit të grupit të vënë në shënjestër; përkundrazi, këto formulime përdoren për të dhënë

²⁰⁸ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 49.

²⁰⁹ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 50-51, 57.

²¹⁰ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 52.

²¹¹ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 34, që i referohet Vendimit të Konfirmimit, para. 126, 448.

²¹² Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 34.

shembuj që lidhen posaçërisht me grupet e personave që përfshihen në të.²¹³ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se këto fraza duhen lexuar edhe duke mbajtur parasysh paragrafët e tjerë të Aktakuzës së Konfirmuar, të cilët identifikojnë më tej persona dhe kategori personash që bëjnë pjesë në grupin qartësisht të përkufizuar të “kundërshtarëve”, ndërsa çdo hollësi tjetër lidhur me identitetet e anëtarëve të grupit është çështje provash në gjykim.²¹⁴

(b) Konstatim

132. Sa u takon elementeve të përgjithshme të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paragrafi 32 i Aktakuzës së Konfirmuar jep përkufizimin e “kundërshtarëve”, që pretendohet se përbëjnë “popullatën civile” kundër së cilës pretendohet se është kryer një sulm gjerësisht i përhapur ose sistematik,²¹⁵ si edhe të viktimave të krimeve për të cilat ngrihen akuzat.

133. Në lidhje me faktin se “Kundërshtarët” përkufizohen se përfshijnë ata që “ishin bashkëpunëtorë” ose “kishin lidhje” me forcat e RFJ-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se çështja nëse individët e përkufizuar kështu mund apo nuk mund të konsiderohen se kanë marrë pjesë aktive në veprime luftarake, përbën çështje provash për t’u diskutuar në gjykim. Po kështu, edhe përkufizimi ligjor i “popullatës civile” dhe nëse “kundërshtarët”, siç janë përkufizuar në Aktakuzën e Konfirmuar, e përmbushin këtë kriter, janë çështje për t’u vendosur në gjykim. Rrjedhimisht, kundërshtimet e Mbrojtjes së Thaçit në këtë aspekt rrëzohen.

134. Sa i takon përdorimit të frazës “ndër të cilët” në pjesën e dytë të përkufizimit të “kundërshtarëve” (paragrafi 32(b) i Aktakuzës së Konfirmuar, ku

²¹³ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 35.

²¹⁴ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 35.

²¹⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 16.

mbështetet Mbrojtja e Thaçit), Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo frazë është vendosur përpara një liste që synon të ofrojë më shumë konkretësi lidhur me një kategori të përcaktuar, që është pjesë e grupit që pretendohet të jetë vënë në shënjestër, pra persona që (perceptoheshin se) “nuk mbështetnin qëllimet dhe metodat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së”. Për rrjedhojë, në dallim nga zgjerimi i fushëveprimit të Aktakuzës së Konfirmuar, fraza “ndër të cilët” dhe lista që vjen pas saj ofrojnë më shumë konkretësi lidhur me grupin që pretendohet të jetë vënë në shënjestër.

135. Sa i takon përfshirjes së frazës “të kombësive të tjera” në të njëjtën fjali të paragrafit 32 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, duke u shprehur se një pjesë e grupit të synuar të pretenduar përbëhej nga “persona të lidhur me LDK-në dhe serbë, romë dhe *persona të kombësive të tjera*” (theksimi i shtuar), Aktakuza e Konfirmuar është mjaftueshmërisht konkrete sa i takon anëtarësisë së një grupi të tillë. Gjithashtu, duke rikujtuar se Aktakuza e Konfirmuar duhet lexuar si e tërë,²¹⁶ përkufizimi i dhënë në paragrafin 32 të Aktakuzës së Konfirmuar duhet lexuar së bashku me paragrafët e tjerë të Aktakuzës së Konfirmuar, të cilët ofrojnë më shumë konkretësi në lidhje me viktimat e krimeve për të cilat ngrihen akuzat²¹⁷ – ndër të tjera edhe sa i takon kombësisë²¹⁸ – dhe, për rrjedhojë, për anëtarët e grupit që pretendohet të jetë vënë në shënjestër.

136. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përdorimi i frazave “ndër të cilët” dhe “të kombësive të tjera” në paragrafin 32 të

²¹⁶ *Shih më lart* para. 28.

²¹⁷ *Shih më poshtë* para. 152.

²¹⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. Aktakuza e Konfirmuar, para. 71, 98, 99, 100, 101, 103, 104, 110, 112, 117, 119, 120, 121, 122, 123, 125, 129, 130, 131, 133, 151, 152, 156, 170, Lista B. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse disa të dhëna që kanë të bëjnë me viktimat e pretenduara janë aktualisht të redaktuara për Mbrojtjen, në përputhje me masat mbrojtëse të miratuara në procedurë gjyqësore, këto redaktime nuk e cenojnë konkretësinë e Aktakuzës së Konfirmuar sepse çdo e dhënë e tillë e redaktuar do t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes në kohën e duhur.

Aktakuzës së Konfirmuar nuk do të thotë se ka mangësi argumentimi e elementeve të përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit.

3. Përndjekja

(a) Parashtrimet

137. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se krimi i përndjekjes është argumentuar në mënyrë joadekuate ngaqë: (i) paragrafi 58(g) dhe (h) i Aktakuzës së Konfirmuar nuk i identifikon viktimat e pretenduara apo datat e krimeve të pretenduara dhe përdor në mënyrë të palejueshme frazën e hapur “ndër të cilat edhe ato të identifikuar në Listën A”;²¹⁹ dhe (ii) paragrafi 58(i) i Aktakuzës së Konfirmuar përdor në mënyrë të palejueshme frazën e hapur “ndër të cilat”, gjë që përkeqësohet nga përdorimi i fjalës “shembuj” dhe përmendja e një periudhe kohore “para, gjatë dhe pas periudhës së Aktakuzës” në paragrafin paraardhës; gjithashtu, aty nuk përmenden veprime konkrete të kontrolleve arbitrare, marrjes së deklaratave nën shtrëngim ose detyrim apo të frikësimit, nuk jepet data, vendi, viktimat apo hollësi të tjera të veprimeve përkatëse dhe nuk bëhet lidhja e asnjë prej këtyre hollësive konkretisht me z. Krasniqi.²²⁰

138. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja i lexon të veçuara disa pjesë të akuzës mbi përndjekjen dhe nuk merr parasysh asnjë prej veprimeve të veçanta të dhënies së paligjshme të dënimeve, përvetësimit të sendeve personale dhe masave të tjera kufizuese dhe diskriminuese që pretendohen në pjesë të tjera të Aktakuzës së Konfirmuar.²²¹ Ajo parashtron se të dhëna të tilla janë paraqitur për të dalluar elementet e përndjekjes në funksion të konfirmimit, por nuk duhen kuptuar se

²¹⁹ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 49.

²²⁰ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 50.

²²¹ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 40.

zvogëlojnë shtrirjen e fushatës së pretenduar të përndjekjeve, e cila është argumentuar qartë.²²²

(b) Konstatim

139. Sa i takon akuzës për përndjekje, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren që në fillim se paragrafët 57-58 të Aktakuzës së Konfirmuar duhen lexuar së bashku me akuzat për burgim/ndalim arbitrar, veprime të tjera çnjerëzore/trajtim mizor, torturë, vrasje të paligjshme dhe zhdukje me forcë, siç parashtrihen në paragrafët 59-171 dhe Listat A-C të Aktakuzës së Konfirmuar.²²³

140. Sa i takon përdorimit të fjalës “shembuj” në paragrafin 57 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fjalia e dytë e paragrafit 57 të Aktakuzës së Konfirmuar, duke përmendur një shtrirje gjeografike dhe kohore që shkon përtej asaj të akuzave të ngritura në këtë çështje gjyqësore, synon vendosjen në kontekst të akuzës për përndjekje, siç shpjegohet më tej një paragraf më pas. Gjithashtu, të njëjtat aspekte duhen mbajtur parasysh edhe sa i takon përdorimit të frazës “duke përfshirë edhe” në fjalinë e parë të paragrafit 57 të Aktakuzës së Konfirmuar. Por, nëse do të lireshin aty frazat “shembuj” dhe “duke përfshirë edhe”, atëherë vërtet do t’i lihej hapësirë ZPS-së të sillte në gjykim prova (të llojeve) të veprimeve të tjera përndjekëse të pretenduara shtesë. Në këto rrethana, zëvendësimi i fjalës “shembuj” me fjalën “tregues” në fjalinë e dytë të paragrafit 57 të Aktakuzës së Konfirmuar dhe eliminimi i frazës “duke përfshirë edhe” nga fjalia e parë e paragrafit 57 të Aktakuzës së Konfirmuar do të ndreqte çdo dykuptimshmëri të lindur dhe do të sqaronte se çfarëdo (lloj) veprimesh të tjera bazë të përndjekjes përpos atyre që janë përfshirë tani, nuk janë pjesë e akuzave të ngritura në këtë çështje gjyqësore.

²²² Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 40.

²²³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 58-59, 94, 136, 171.

141. Sa i takon përdorimit të frazës “ndër të tjera edhe” në fjalinë hapëse të paragrafit 58 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se qëllimi i këtij paragrafi është dhënia e një informacioni të përgjithshëm mbi veprimet e pretenduara të përndjekjes, siç renditen në shkronjat (a)-(i) aty. Lista e veprimeve që vjen pas frazës “ndër të tjera edhe” ka për synim të jetë një renditje shteruese e veprimeve të pretenduara të përndjekjes. Por, nëse do të lihej aty fraza “ndër të tjera edhe” atëherë kjo vërtet mund t’i lejojë hapësirë ZPS-së të sjellë në gjykim prova për lloje shtesë veprimesh përndjekëse të pretenduara. Në këto rrethana, eliminimi i frazës “ndër të tjera edhe” nga fjalia hapëse e paragrafit 58 do të ndreqte çdo dykuptimshmëri të lindur dhe do të sqaronte se lloje të tjera shtesë të veprimeve bazë të përndjekjes, që nuk janë paraqitur në Aktakuzë, nuk janë pjesë e akuzës së ngritur për përndjekje në këtë çështje gjyqësore.

142. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon më tej se i njëjti arsyetim vlen për përdorimin e frazave “ndër të cilat edhe”, “përfshirë edhe” dhe “ndër të cilat” në shkronjat (g)-(i) të paragrafit 58 të Aktakuzës së Konfirmuar. Për të shmangur çdo dykuptimshmëri sa u takon (llojeve të) veprimeve të pretenduara të përndjekjes, frazat “ndër të cilat edhe” dhe “përfshirë edhe” duhen hequr nga paragrafi 58(g) dhe (h), ndërsa në paragrafin 58(i) fraza “ndër të cilat” të zëvendësohet me frazën “që janë”.

143. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të dorëzojë një version të korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar ku: (i) të zëvendësojë fjalën “shembuj” me fjalën “tregues” në fjalinë e dytë të paragrafit 57 të Aktakuzës së Konfirmuar; (ii) të heqë frazën “duke përfshirë edhe” nga fjalia e parë e paragrafit 57 të Aktakuzës së Konfirmuar dhe frazën “ndër të tjera edhe” nga fjalia hapëse e paragrafit 58; (iii) të heqë frazat “ndër të cilat edhe” dhe “përfshirë edhe” nga paragrafi 58(g) dhe (h); dhe (iv) të zëvendësojë frazën “ndër të cilat” me frazën “që janë” në paragrafin 58(i) të Aktakuzës së Konfirmuar.

144. Sa i takon pretendimit se paragrafi 58(g)-(i) i Aktakuzës së Konfirmuar nuk përcakton asnjë rast konkret apo hollësi shtesë të veprimeve të pretenduara të përndjekjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se veprimet bazë të përndjekjes që pretendohen, të renditura në pikat (g)-(i), edhe pse nuk ngrihen si akuza për krime më vete, duhen lexuar së bashku me paragrafët 59-171 të Aktakuzës së Konfirmuar. Një lexim i tillë ofron informacion adekuat sa u takon rasteve të pretenduara të dhënies së paligjshme të dënimeve, përvetësimit të sendeve personale dhe vendosjes dhe mbajtjes së masave të tjera kufizuese dhe diskriminuese, përfshirë informacione lidhur me datën e përafërt, vendin, viktimat e pretenduara dhe hollësi të tjera të veprimeve të pretenduara.²²⁴ Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, të lexuara në kontekstin e tërë Aktakuzës së Konfirmuar, dhe me kushtin e vendosur më lart lidhur me frazat “ndër të cilat edhe”, “përfshirë edhe”, “ndër të cilat” dhe “shembuj” të përdorur aty, paraqitja e bërë në paragrafin 58(g)-(i) të Aktakuzës së Konfirmuar jep me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme faktet mbi të cilat mbështetet akuza e ngritur për përndjekje.

145. Sa i takon lidhjes së të akuzuarve me krimet për të cilat ngrihen akuzat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet arsytetimeve që bën në Pjesën IV.F.6. më poshtë.

²²⁴ *Shih*, për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 98, 99, 100, 126 dhe 128 (ku jepen të dhëna të tjera lidhur me rastet e pretenduara të përvetësimit të sendeve personale), 110 dhe 116 (ku jepen të dhëna të tjera lidhur me rastet e pretenduara të dhënies së paligjshme të dënimeve).

4. Burgosja/ndalimi arbitrar, akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor, vrasje e paligjshme dhe tortura

(a) Parashtrimet

146. Mbrojtja e Thaçit parashtron se Aktakuza e Konfirmuar nuk paraqet me nivelin e kërkuar të konkretësisë disa prej fakteve materiale të krimeve për të cilat ngrihen akuzat.²²⁵ Në veçanti, ajo pretendon se Aktakuza e Konfirmuar: (i) nuk përcakton identitetet e kryesve, me përjashtim të përmendjes në përgjithësi se ishin “anëtarë të UÇK-së”; (ii) nuk përcakton identitetin e shumë prej viktimave; (iii) është e mjegullt sa i takon vendndodhjes së disa krimeve; (iv) jep hollësi të pamjaftueshme sa i takon lidhjes së z. Thaçi me krimet dhe rolit që akuzohet se ka luajtur; dhe (v) nuk jep disa hollësi të caktuara në lidhje me disa prej krimeve dhe viktimave të tyre.²²⁶ Mbrojtja e Krasniqit shton se: (i) në një sërë rastesh, Aktakuza e Konfirmuar nuk jep disa hollësi në lidhje me viktimat e transferuara në dhe nga qendra të papërcaktuara ndalimi të UÇK-së;²²⁷ dhe (ii) përdorimi i frazës së hapur “ndër të cilët” apo “përfshirë edhe” në një sërë rastesh është i palejueshëm.²²⁸

147. Në veçanti, sa i takon torturës, Mbrojtja e Thaçit pretendon se Aktakuza e Konfirmuar është e paqartë se: (i) cilët anëtarë dhe instrumente të NKP-së i kryen veprimet që përbëjnë torturë, kur, ku dhe kundër kujt; (ii) cili ishte roli i z. Thaçi në to.²²⁹

148. Sa i takon paraqitjes së krimeve të veçanta, ZPS-ja përgjigjet se Aktakuza e Konfirmuar paraqet faktet materiale – që janë, për aq sa është e mundur, vendi, ora dhe numri i përafërt i viktimave, përfshirë të dhëna të nevojshme për të dalluar

²²⁵ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 58.

²²⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 58-59, ku i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, para. 60-63, 65-93, 97-133, 137-170.

²²⁷ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 60, ku i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, para. 76, 78, 79.

²²⁸ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 59, ku i referohet ndër të tjera Aktakuzës së Konfirmuar, para. 59, 94-95, 136.

²²⁹ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 59, ku i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, para. 135.

elementet e krimeve për të cilat ngrihen akuzat.²³⁰ Ajo parashton gjithashtu se, për nga vetë natyra e tyre dhe sikurse argumentohet në këtë çështje: (i) burgosja/ndalimi arbitrar dhe zhdukja me forcë janë të dyja krime në vijimësi, që do të thotë se në përgjithësi kryerja e tyre nuk përfundon me një veprim të caktuar në një kohë të caktuar në një vend të caktuar dhe me gjasë mund të vijojë – edhe për një periudhë të zgjatur kohe përmes veprimeve dhe mosveprimeve të personave të ndryshëm në vendndodhje të ndryshme – për sa kohë që përmbushen elementet përkatëse; dhe (ii) përndjekja, veprimet e tjera çnjerëzore/trajtimi mizor dhe tortura mund të përbëhen nga një varg veprimesh dhe/ose të bazohen në marrjen parasysh të tërësisë së veprimeve dhe mosveprimeve me gjasë të kryera nga persona të ndryshëm dhe kundër personave të ndryshëm, gjatë një periudhe të zgjatur kohore dhe në vendndodhje të ndryshme.²³¹ Gjithashtu, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, ndër të tjera natyrën dhe shtrirjen e krimeve dhe të formave të përgjegjësisë penale të përfshira në Aktakuzë, nuk është e nevojshme që Aktakuza e Konfirmuar të renditë të gjitha veprimet kriminale mbi të cilat bazohet çdo akuzë.²³² Në këtë kuadër, terma të tillë si “rreth”, “ndër të tjera”, “ndër të cilat”, “përfshirë edhe”, “përfshihej” dhe “shembuj” janë përdorur siç duhet për të dhënë hollësi të tjera të ditura në mbështetje të fakteve materiale të paraqitura, ndër të tjera, në lidhje me disa data, vende, viktimë, kryes dhe mënyra kryerjeje të caktuara dhe nuk krijojnë paqartësi lidhur me akuzat.²³³ Sipas parashtrimit të ZPS-së, hollësitë shtesë që kërkon Mbrojtja – përfshirë identitetet e veçanta të viktimave dhe kryesve, datat e sakta, llojet e veçanta të keqtrajtimit, vendet e veçanta dhe lidhjen e saktë midis të akuzuarve dhe veprimeve kriminale të veçanta – janë çështje provash për gjykim.²³⁴

²³⁰ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 36-37, 42.

²³¹ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 38 dhe referencat aty.

²³² Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 39 dhe referencat aty.

²³³ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 39.

²³⁴ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 42 dhe referencat aty.

149. Në kundërpërgjigje, Mbrojtja e Thaçit parashtron se: (i) kryerja në vijimësi e një krimi, në vetvete, nuk e çliron ZPS-në nga detyrimi për të paraqitur të gjitha faktet materiale që ka në zotërim, në mënyrë që t'u japë mundësi të akuzuarve të përgatitin mbrojtjen;²³⁵ dhe (ii) në dallim nga parashtrimi i ZPS-së, përdorimi i termave të tillë joshterues si “ndër të cilat”, “ndër të tjera edhe” apo “përfshirë edhe” është i palejueshëm sepse krijon paqartësi.²³⁶ Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Krasniqit pretendojnë më tej se ZPS-ja nuk bën asnjë orvatje për të treguar se përdorimi i frazave “ndër të cilat”, “ndër të tjera” dhe “përfshirë edhe” ka qenë veçanërisht i nevojshëm dhe se përdorimi i tyre i jep mundësi ZPS-së ta zgjerojë çështjen e vet në gjykim.²³⁷

(b) Konstatim

(i) Burgosja/ndalimi arbitrar, akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor dhe vrasje e paligjshme

150. Sa u takon akuzave për burgosje/ndalim të arbitrar, akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor dhe vrasje të paligjshme (bashkërisht “pesë krimet e pretenduara”), Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren që në fillim se: (i) akuzat për burgosje/ndalim arbitrar duhen lexuar së bashku me Listën A;²³⁸ (ii) akuzat për akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor duhen lexuar së bashku me Listën A dhe paragrafët 60-93 të Aktakuzës së Konfirmuar, që kanë të bëjnë me akuzat për burgosje/ndalim arbitrar;²³⁹ dhe (iii) akuza për vrasje të paligjshme duhet lexuar së bashku me Listat A dhe B dhe akuzat për akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor dhe burgosje/ndalim arbitrar.²⁴⁰

²³⁵ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 14 dhe referencat aty.

²³⁶ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 15.

²³⁷ Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 22; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 28-30.

²³⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 59.

²³⁹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 94.

²⁴⁰ Aktakuza e Konfirmuar, para. 136.

151. Sa i takon identitetit të kryesve fizikë²⁴¹ të pesë krimeve të pretenduara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në një sërë rastesh, identitetet e (disa prej) kryesve fizikë jepen në Aktakuzën e Konfirmuar.²⁴² Sa u takon atyre emri i të cilëve nuk jepet konkretisht, Aktakuza e Konfirmuar i identifikon më tej sipas grupimit dhe përkatësisë (“anëtarë të UÇK-së”/“ushtarë të UÇK-së”, pra persona të lidhur me UÇK-në gjatë periudhës kohore të Aktakuzës së Konfirmuar),²⁴³ dhe në disa raste, i lidh këta me zona operative,²⁴⁴ njësi të veçanta²⁴⁵ ose me komandantë të përmendur me emër.²⁴⁶ Sa i takon numrit të vogël të rasteve kur, për shkak të përdorimit të diatezës pësore në formulimin e akuzave, kryesit e pretenduar fizikë që lidhen me incidente të veçanta nuk përmenden shprehimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se një lexim kontekstual i paragrafëve në fjalë e bën të qartë se edhe këta kryes pretendohet se kanë qenë anëtarë të UÇK-së,²⁴⁷ në një rast të identifikuar më tej sipas njësisë dhe zonës operative.²⁴⁸ Duke qenë se për krimet dhe format e përgjegjësisë të përfshira në Aktakuzë nuk është e nevojshme të jepet identiteti konkret i kryesve fizikë²⁴⁹ dhe duke pasur parasysh natyrën dhe shkallën e krimeve për të cilat ngrihen akuzat në këtë çështje, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është e nevojshme që në Aktakuzën e Konfirmuar të paraqiten më tej të dhëna të tjera shtesë lidhur me

²⁴¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake e përdor termin “kryes fizikë” për t’iu referuar individëve që pretendohet se i kanë kryer drejtpërdrejt krimet për të cilat akuzohen të akuzuarit përmes formave të ndryshme të përgjegjësisë të cilave u referohet Aktakuza e Konfirmuar.

²⁴² Aktakuza e Konfirmuar, para. 60, 61, 62, 68, 75, 78, 79, 97, 98, 110, 112, 115, 116, 117, 143, 154, 155, 156, 161, 164.

²⁴³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 60, 61, 62, 65, 66, 67, 68, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 137, 138, 140, 141, 143, 144, 145, 146, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 158, 159, 160, 161, 162, 164, 165, 166, 167, 168, 169, 170.

²⁴⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 60, 67, 68, 71, 72, 77, 80, 93.

²⁴⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 72, 77.

²⁴⁶ Aktakuza e Konfirmuar, para. 60, 61, 67, 68, 77.

²⁴⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 63, 69, 70, 72, 80, 81, 132, 133, 139, 142, 147, 156, 157, 163.

²⁴⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 72.

²⁴⁹ *Shih më lart* para. 35-37.

identitetin e kryesve fizikë të pesë krimeve të pretenduara. Këto të dhëna janë çështje provash që mund të diskutohen në gjykim.

152. Sa i takon identitetit të viktimave të pesë krimeve të pretenduara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se disa prej tyre identifikohen me emër, ose si të afërm të një personi të përmendur me emër,²⁵⁰ ndërsa të tjerët identifikohen duke dhënë ose numrin e saktë, ose numrin minimal të përafërt të tyre.²⁵¹ Gjithashtu, viktimat e pretenduara të burgosjes/ndalimit arbitrar dhe të akteve të tjera çnjerëzore/trajtimin mizor identifikohen më tej si persona të ndaluar në një qendër të veçantë ndalimi gjatë një periudhe të caktuar kohore.²⁵² Gjithashtu, në lidhje me disa prej viktimave, jepen të dhëna të tjera shtesë, si: (i) kombësia;²⁵³ (ii) përkatësia (e perceptuar) politike;²⁵⁴ (iii) fakti që transferoheshin në ose nga qendra të tjera ndalimi ose bëheshin objekt keqtrajtimi të pretenduar në vende të tjera;²⁵⁵ dhe (iv) të dhëna të tjera të veçanta për çdo krim.²⁵⁶ Duke pasur parasysh: (i) faktin se është dhënë informacion i hollësishëm lidhur me viktimat e pesë krimeve të pretenduara, kur ky informacion ka qenë i disponueshëm; (ii) natyrën dhe shkallën e krimeve për të cilat ngrihen akuzat, sidomos faktin se pretendohet se janë kryer kundër qindra viktimave;²⁵⁷ dhe (iii) faktin se të akuzuarit nuk

²⁵⁰ Aktakuza e Konfirmuar, para. 126, 127, 128, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 152, 153, 154, 155, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168, 169, Lista B. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse disa prej emrave dhe të dhënave të viktimave të pretenduara janë aktualisht të redaktuara për Mbrojtjen, në përputhje me masat mbrojtëse të miratuara në procedurë gjyqësore, këto redaktime nuk e cenojnë konkretësinë e Aktakuzës së Konfirmuar sepse çdo e dhënë e tillë e redaktuar do t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes në kohën e duhur.

²⁵¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 60, 61, 62, 63, 65, 66, 67, 68, 69, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 105, 107, 109, 119, 129, 132, 133, 151, 156, Lista A.

²⁵² Aktakuza e Konfirmuar, para. 60-93, 97-134, Lista A. *Shih edhe më poshtë* para. 154.

²⁵³ Aktakuza e Konfirmuar, para. Aktakuza e Konfirmuar, para. 71, 98, 99, 100, 101, 103, 104, 110, 112, 117, 119, 120, 121, 122, 123, 125, 129, 130, 131, 133, 151, 152, 156, 170, Lista B.

²⁵⁴ Aktakuza e Konfirmuar, para. 99, 100, 101, 104, 105, 106, 114, 115.

²⁵⁵ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 60, 62, 63, 65, 67, 69, 70, 74, 76, 78, 79, 82, 84, 85, 91, 92, 105, 107, 113, 132, 152, 154.

²⁵⁶ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 71 dhe 156 (pas mbërritjes së tij nga një territor nën kontrollin e serbëve), 73 dhe 107 ([REDAKTUAR]), 93 dhe 170 (i moshuar serb), 110 ([REDAKTUAR]).

²⁵⁷ *Shih më lart* para. 128.

akuzohen se kanë kryer vetë fizikisht ndonjë prej krimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është nevoja të paraqiten në Aktakuzën e Konfirmuar të dhëna të tjera shtesë lidhur me identitetin e viktimave të pesë krimeve të pretenduara. Këto të dhëna janë çështje provash që mund të diskutohen në gjykim.

153. Sa i takon vendit të kryerjes së pesë krimeve të pretenduara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën konstatimet në vijim. Lidhur me akuzat për burgosje/ndalim arbitrar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se pretendohet se krimet janë kryer në 42 qendra ndalimi me personel të UÇK-së dhe të përdorura prej saj, të identifikuara sipas emrit të vendbanimit (p.sh., qytet, qytezë, fshat ose lagje) ku pretendohet se ndodheshin, si edhe duke përmendur komunën ose rrethin përkatës.²⁵⁸ Sa u takon akuzave për akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se pretendohet se këto janë kryer ose në një prej qendrave të identifikuara të ndalimit të lartpërmendura, ose në një vend tjetër të identifikuar në mënyrë të ngjashme.²⁵⁹ Gjithashtu, në një sërë rastesh, jepen të dhëna të tjera lidhur me vendin e pretenduar të krimit, ndër të tjera duke përmendur ndërtesa të veçanta ku pretendohet se janë mbajtur të ndaluar individët.²⁶⁰ Sa u takon rasteve kur pretendohet se krimi është kryer “në [një vend të përmendur me emër] ose afër tij”,²⁶¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton

²⁵⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 59-93, Lista A.

²⁵⁹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 94-134.

²⁶⁰ Aktakuza e Konfirmuar, para. 60 (ish-stacion policie), 61 (kompleks që shërbente edhe si kazermë), 62 (kompleks të ndarë me rrethojë), 63 (shtab të UÇK-së, përfshirë edhe në një ish-ndërtesë shkollë dhe një ish-zyrë regjistrimi), 65 dhe 101 (ish-stacion policie), 66 (bodrum i një shtabi të UÇK-së), 68 (vend afër policisë ushtarake dhe shtabit të zonës), 69 (shtab të UÇK-së), 71 (në mes të fshatit), 72 (një vend që përdorej nga anëtarë të UÇK-së dhe një kompleks që përdorej si bazë e sigurt dhe qendër për marrje në pyetje dhe ndalim nga anëtarët e njësitit gueril BIA), 73 dhe 107 ([REDAKTUAR]), 74 ([REDAKTUAR]), 78 (një dhomë në kazermën ushtarake të UÇK-së), 79 (ish-fabrikë metali), 80 (shtab i UÇK-së), 81 (shtab i UÇK-së), 84 dhe 122 ([REDAKTUAR]), 85 dhe 123 (ish-ndërtesa e MPB-së), 86 dhe 124 ([REDAKTUAR]), 87 dhe 125 ([REDAKTUAR]), 90 dhe 131 (shtab i UÇK-së në një ish-shkollë me konvikt dhe në konviktin e saj), 91 dhe 132 (ish-stacion policie), 92 dhe 133 (shtab i UÇK-së i vendosur [REDAKTUAR]), 93 (bazë e UÇK-së), 126 (shtëpi e një individi të përmendur me emër), 127 ([REDAKTUAR]), 128 ([REDAKTUAR]).

²⁶¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 71, 82, 88, 129.

se kjo nuk krijon paqartësi në paraqitje në Aktakuzë, duke vërejtur se mund të mos jetë e mundshme të përcaktohen qartë kufijtë precizë të vendbanimeve në fjalë dhe se çështja nëse vendndodhja e qendrave të pretenduara të ndalimit mund të konsiderohet se është “në vendbanim ose pranë tij” përbën çështje për të cilën vendoset në gjykim. Sa i takon akuzës për vrasje të paligjshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Aktakuza e Konfirmuar i referohet ose: (i) vendit të veprimeve ose sjelljes së pretenduar që përbën vrasje të paligjshme; ose (ii) vendit dhe/ose rrethanave në të cilat janë parë gjallë për herë të fundit viktimat e pretenduara, të identifikuara në mënyrë të ngjashme sipas emrit të vendbanimit dhe komunës ose rrethit ku ndodhet ai vendbanim.²⁶² Gjithashtu, në disa raste, përcaktohet vendi ku janë gjetur më pas kufomat e viktimave të pretenduara.²⁶³ Duke pasur parasysh: (i) faktin se është dhënë, sipas rastit, informacion i hollësishëm lidhur me vendin e pesë krimeve të pretenduara; (ii) natyrën dhe shkallën e krimeve për të cilat ngrihen akuzat; dhe (iii) faktin se të akuzuarit nuk akuzohen se kanë kryer vetë fizikisht ndonjë prej krimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është nevoja të paraqiten në Aktakuzën e Konfirmuar të dhëna të tjera shtesë lidhur me vendin ku janë kryer pesë krimet e pretenduara. Këto të dhëna janë çështje provash që mund të diskutohen në gjykim.

154. Sa i takon kohëzgjatjes së pretenduar të burgosjes/ndalimit arbitrar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren që në fillim se burgosja/ndalimi arbitrar janë krime në vijimësi, të cilat kryhen për aq kohë sa personit i hiqet liria fizike pa proces ligjor të rregullt/pa bazë ligjore ose pa përmbushur garancitë procedurale bazë.²⁶⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se Aktakuza e Konfirmuar përcakton datat e përafërta se kur pretendohet se u është hequr liria personave në

²⁶² Aktakuza e Konfirmuar, para. 136-170, Lista B.

²⁶³ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 137, 138, 144, 148, 150, 151, 153, 154, 155, 157, 161, 162.

²⁶⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 57-60, 93-96.

secilin prej vendeve që lidhen me akuzat.²⁶⁵ Në veçanti, rastet e burgosjes/ndalimit arbitrar për të cilat ngrihen akuzat pretendohet se kanë ndodhur gjatë periudhave të përcaktuara kohore që shkojnë nga një ose dy ditë²⁶⁶ deri në disa muaj.²⁶⁷ Në këto rrethana dhe duke pasur parasysh shkallën e kryerjes së pretenduar të burgosjes/ndalimit arbitrar që përshkruan Aktakuza e Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është nevoja të paraqiten më tej në Aktakuzën e Konfirmuar të dhëna të tjera shtesë që tregojnë me saktësi se cilët të ndaluar janë ndaluar dhe për sa kohë dhe/ose gjatë cilës periudhë. Këto të dhëna janë çështje provash që mund të diskutohen në gjykim.

155. Sa i takon përdorimit të formulimit “rreth” në rastin e datave të veçanta,²⁶⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në të gjitha rastet,²⁶⁹ ky formulim ofron konkretësi të mjaftueshme, duke pasur parasysh se Aktakuza e Konfirmuar jep edhe informacione të tjera në lidhje me kryesit e pretenduar fizikë, viktimat e pretenduara dhe vendin e pretenduar të kryerjes së krimeve për të cilat ngrihen akuzat, në mënyrën e treguar më lart.

156. Sa i takon: (i) çështjes se cilat viktima të veçanta pretendohet se u janë nënshtruar formave të veçanta të keqtrajtimit;²⁷⁰ dhe (ii) parashtrimin të Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Krasniqit se, në një sërë rastesh, Aktakuza e Konfirmuar nuk jep të dhëna të caktuara lidhur me viktimat që pretendohet se janë transferuar

²⁶⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 60-93, Lista A.

²⁶⁶ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, [REDAKTUAR].

²⁶⁷ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 68, 75.

²⁶⁸ Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 60.

²⁶⁹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 62, 64, 65, 69, 70, 73, 77, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 93, 97, 99, 101, 105, 106, 107, 110, 111, 114, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 132, 133, 143, 144, 145, 147, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 157, 163, 164, 166, 168, 169. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “rreth kësaj date” në paragrafët 64 dhe 111 të Aktakuzës së Konfirmuar është aktualisht e redaktuar për Mbrojtjen, në zbatim të masave mbrojtëse të miratuara me procedurë gjyqësore. Ky redaktim do të hiqet në kohën e duhur.

²⁷⁰ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 59, ku i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, para. 102, 103, 107, 109, 116, 121, 123, 124, 125, 130, 131.

në dhe nga qendra të papërcaktuara ndalimi të UÇK-së,²⁷¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton natyrën dhe shkallën e burgosjes/ndalimit arbitrar dhe të akteve çnjerëzore/trajtimit mizor të lidhur me ndalimin në këtë çështje gjyqësore, çka mund ta bëjë të pamundur konstatimin e identitetit të viktimave, si edhe faktin se të akuzuarit nuk akuzohen se kanë kryer vetë fizikisht ndonjë prej krimeve. Në këtë rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është e nevojshme përmendja konkrete e identiteteve të viktimave të pretenduara, nëse nuk dihen. Në të vërtetë, mjafton që Mbrojtjes t'i jepet numri i përafërt i viktimave të pretenduara për çdo vend, krahas të dhënave për periudhën kohore dhe vendin ku pretendohet se janë kryer krimet dhe veçanti të tjera si, për shembull, kombësia²⁷² dhe/ose përkatësia (e perceptuar) politike e viktimave²⁷³ ose të dhëna të tjera në lidhje me vendngjarjen e pretenduar të krimeve.²⁷⁴ Po kështu, duke pasur parasysh format e përgjegjësisë të përfshira në Aktakuzën e kësaj çështjeje, mjafton që kryesit të identifikohen sipas kategorisë ose grupit në lidhje me një vendngjarje të veçantë krimi. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se informacioni në lidhje me transferimin e pretenduar të viktimave midis qendrave të ndalimit përbën informacion shtesë kontekstual i cili nuk lipset të paraqitet në Aktakuzën e Konfirmuar. Për pasojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Aktakuza e Konfirmuar nuk lipset të japë të dhëna të tjera në lidhje me: (i) viktimat *e veçanta* që u janë nënshtruar formave të *veçanta* të keqtrajtimit të pretenduar; ose (ii) të dhëna të tjera sa u takon viktimave të transferuara në dhe nga qendrat e ndalimit të UÇK-së. Këto përbëjnë çështje provash që mund të diskutohen në gjykim.

²⁷¹ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 59, ku i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, para. 60, 63, 67, 70, 74, 75, 76, 78, 79, 81, 82, 84, 85, 91; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 60.

²⁷² *Shih më lart* poshtëshënimi 253.

²⁷³ *Shih më lart* poshtëshënimi 254.

²⁷⁴ *Shih më lart* poshtëshënimi 260.

157. Sa u takon formave të tjera të keqtrajtimit të pretenduar, krahas atyre që janë paraqitur konkretisht në Aktakuzën e Konfirmuar,²⁷⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se secili prej paragrafëve të Aktakuzës së Konfirmuar të cilëve u referohet Mbrojtja e Thaçit jep një shpjegim bindës dhe të hollësishëm faktik të krimeve të pretenduara dhe se hollësitë e tjera të kërkuara përbëjnë çështje provash që mund të diskutohen në gjykim.

158. Sa u takon hollësive të caktuara të tjera të cilave u referohet Mbrojtja e Thaçit,²⁷⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ato nuk përbëjnë fakte mbi të cilat mbështeten akuzat dhe, rrjedhimisht, nuk është nevoja të paraqiten në Aktakuzën e Konfirmuar. Këto përbëjnë çështje provash që mund të diskutohen në gjykim.

159. Sa i takon përdorimit të frazave “duke përfshirë edhe”, “ndër të cilat” dhe “përfshijnë” në paraqitjen e pesë krimeve të pretenduara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën konstatimet në vijim. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se: (i) përdorimi i frazave “duke përfshirë edhe” në paragrafin 59 (fjalja e parë), “ndër të cilat” në paragrafin 94 (fjalja e parë), “ndër të cilat” në paragrafin 95 (fjalja e fundit) dhe “ndër të cilat” në paragrafin 136 (fjalja e dytë) të Aktakuzës së Konfirmuar; dhe (ii) përdorimi i fjalës “përfshijnë” në fjalinë e fundit të paragrafit 136 të Aktakuzës së Konfirmuar vërtet mund t’i linin hapësirë ZPS-së të paraqiste në gjykim prova: (i) për qendra ndalimi të tjera shtesë të pretenduara prej saj se kishin kushte çnjerëzore dhe ku pretendohet se kanë ndodhur akte të dhunës fizike dhe psikologjike; dhe (ii) për incidente të tjera shtesë të pretenduara vrasjesh të paligjshme.

²⁷⁵ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 59, ku i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, para. 126, 127, 128, 157.

²⁷⁶ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 59, ku i referohet Aktakuzës së Konfirmuar, para. 144 (kush ishin të ndaluarit të cilët pretendohet se nuk janë vrasë), 151 (kush ishte i ndaluarit që u arratis për t’i shpëtuar vrasjes së pretenduar), 154 ([REDAKTUAR]).

160. Në këto rrethana, për të ndrequr çdo dykuptimshmëri dhe për të sqaruar se kuadri i akuzave të ngritura në këtë çështje gjyqësore kufizohet në incidentet e pretenduara të burgosjes/ndalimit arbitrar, aktet çnjerëzore/trajtimin mizor dhe vrasjet e paligjshme të cilave u referohet Aktakuza e Konfirmuar, përfshirë Listat A dhe B, sipas rastit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të dorëzojë një version të korigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar ku: (i) të heqë fjalët “duke përfshirë edhe ato” në paragrafin 59 (fjalja e parë), “ndër të cilat edhe ato” në paragrafin 94 (fjali e parë), “ndër të cilat edhe në ato” në paragrafin 95 (fjalja e fundit) dhe “ndër të cilat edhe ato” në paragrafin 136 (fjalja e dytë) të Aktakuzës së Konfirmuar; dhe (ii) të zëvendësojë fjalën “përfshijnë” me fjalën “janë” në fjalinë e fundit të paragrafit 136 të Aktakuzës së Konfirmuar.

161. Sa i takon përdorimit të frazës “ndër të tjera edhe” në fjalinë e parë të paragrafit 136 të Aktakuzës së Konfirmuar dhe të frazës “ndër to përfshihen” në fjalinë e dytë të po këtij paragrafi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se qëllimi i katër fjalive të para të paragrafit 136 është bërja e një paraqitjeje shteruese të tre llojeve të rasteve në të cilat pretendohet se ndodhën vrasjet e kryera nga anëtarët dhe instrumentet e NKP-së, siç shpjegohet në vijim në paragrafët 137-170 të Aktakuzës së Konfirmuar, pra: (i) pas arrestimeve ose rrëmbimeve; (ii) në qendrat e ndalimit ose në lidhje me to; dhe (iii) gjatë kohës së tërheqjes së UÇK-së nga këto qendra përballë ofensivës së forcave të RFJ-së. Rrjedhimisht, përdorimi i frazave “ndër të tjera edhe” dhe “ndër to përfshihen” në rastet e lartpërmendura nuk i japin mundësi ZPS-së në mënyrë të palejueshme të zgjerojë më tej pretendimet faktike të çështjes së saj në gjykim. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej vëren se zëvendësimi i fjalës “përfshin” me “është” në fjalinë e fundit të paragrafit 136 të Aktakuzës së Konfirmuar do të heqë çdo dykuptimshmëri lidhur me faktin se akuza për vrasje të paligjshme në këtë çështje gjyqësore përfshin vetëm incidentet e identifikuar në Listën B dhe më tej të përshkruara në paragrafët 137-170 të Aktakuzës së Konfirmuar.

162. Sa i takon përdorimit të frazave “ndër të cilët” në paragrafin 62 (fjalë e fundit), “duke përfshirë edhe” dhe “ndër të cilat edhe” në paragrafin 63, “duke përfshirë” në paragrafin 65 (fjalë e parë), “ndër të cilat edhe” në paragrafin 67 (fjalë e katërt), “duke përfshirë edhe” në paragrafin 72 (fjalë e fundit), “ndër të cilët” në paragrafin 73 (fjalë e parë), “duke përfshirë edhe” në paragrafin 74 (fjalë e parë), “ndër të cilët” në paragrafin 75 (fjalë e fundit), “ndër të cilët” në paragrafin 77 (fjalë e pestë), “ndër të cilët” dhe “ndër të cilat” në paragrafin 78 (fjalë e parë dhe e fundit), “ndër të cilët” dhe “duke përfshirë edhe” në paragrafin 79 (fjalë e parë dhe e fundit), “përfshirë edhe” në paragrafin 84 (fjalë e fundit), “ndër të cilat edhe” në paragrafin 85 (fjalë e fundit), “ndër të cilat edhe” në paragrafin 91 (fjalë e parë dhe e dytë), “ndër të tjera” dhe “duke përfshirë edhe” në paragrafin 95 (fjalë e parë dhe e dytë; fjalë e fundit, rasti i dytë), “ndër të cilët” në paragrafin 97 (fjalë e dytë dhe e katërt), “ndër të cilët” në paragrafin 98 (fjalë e tretë), “përfshirë edhe” dhe “ndër të tjera edhe” në paragrafin 102 (fjalë e parë dhe e tretë), “duke përfshirë edhe” dhe “ndër të cilët” në paragrafin 112 (fjalë e katërt dhe e fundit),²⁷⁷ “ndër të cilët” në paragrafin 114 (fjalë e fundit),²⁷⁸ “si” dhe “ndër të cilët” në paragrafin 115 (fjalë e parë dhe e tretë), “ndër të cilët” dhe “duke përfshirë edhe” në paragrafin 116 (fjalë e tretë dhe e shtatë), “duke përfshirë edhe” në paragrafin 118 (fjalë e parë),²⁷⁹ “ndër të cilat edhe” dhe “përfshirë edhe” në paragrafin 120 (fjalë e parë dhe e katërt), “përfshirë edhe” në paragrafin 121

²⁷⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “duke përfshirë edhe” në fjalë e katërt të paragrafit 112 të Aktakuzës së Konfirmuar është aktualisht e redaktuar për Mbrojtjen në zbatim të masave mbrojtëse të miratuara me procedurë gjyqësore. Ky redaktim do të hiqet në kohën e duhur.

²⁷⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “ndër të cilët” në fjalë e fundit të paragrafit 114 të Aktakuzës së Konfirmuar është aktualisht e redaktuar për Mbrojtjen në zbatim të masave mbrojtëse të miratuara me procedurë gjyqësore. Ky redaktim do të hiqet në kohën e duhur.

²⁷⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “duke përfshirë edhe” në fjalë e parë të paragrafit 118 të Aktakuzës së Konfirmuar është aktualisht e redaktuar për Mbrojtjen në zbatim të masave mbrojtëse të miratuara me procedurë gjyqësore. Ky redaktim do të hiqet në kohën e duhur.

(fjalë e pestë), “përfshirë” në paragrafin 123 (fjalë e pestë),²⁸⁰ “ndër të cilat edhe” në paragrafin 125 (fjalë e parë), “ndër të cilët edhe” në paragrafin 147 (fjalë e gjashtë),²⁸¹ “ndër të tjera edhe” në paragrafin 152 (fjalë e katërt) dhe “ndër të cilët” në paragrafin 164 (fjalë e dytë) të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në çdo rast të veçantë, formulimi i përdorur pas këtyre frazave ka për qëllim të ofrojë më shumë konkretësi sa u takon incidenteve përkatëse të trajtuara, të tilla si identiteti i disa prej kryesve fizikë,²⁸² hollësi të tjera lidhur me disa prej viktimave²⁸³ ose lidhur me vendin preciz të ndalimit të pretenduar.²⁸⁴ Përcaktimet të tilla nuk i japin mundësi ZPS-së t’i zgjerojë në mënyrë të palejueshme pretendimet faktike të çështjes së saj në gjykim. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përdorimi i frazave të lartpërmendura në ato raste nuk e bën me mangësi paraqitjen e pesë krimeve të pretenduara në Aktakuzë.

163. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se të njëjtat aspekte vlejné për përdorimin e frazave “ndër [...] kishte” në paragrafin 98 (fjalë e fundit), në paragrafin 99 (fjalë e fundit), në paragrafin 100 (fjalë e fundit), në paragrafin 101 (fjalë e fundit), në paragrafin 102 (fjalë e tretë), në paragrafin 103 (fjalë e fundit), në paragrafin 104 (fjalë e fundit), në paragrafin 106 (fjalë e fundit),²⁸⁵ në paragrafin 112 (fjalë e shtatë), në paragrafin 115 (fjalë e fundit), në paragrafin 117

²⁸⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fjala “përfshirë” në fjalinë e pestë të paragrafit 123 të Aktakuzës së Konfirmuar është aktualisht e redaktuar për Mbrojtjen në zbatim të masave mbrojtëse të miratuara me procedurë gjyqësore. Ky redaktim do të hiqet në kohën e duhur.

²⁸¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “ndër të cilët edhe” në fjalinë e gjashtë të paragrafit 147 të Aktakuzës së Konfirmuar është aktualisht e redaktuar për Mbrojtjen në zbatim të masave mbrojtëse të miratuara me procedurë gjyqësore. Ky redaktim do të hiqet në kohën e duhur.

²⁸² Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 79, 97, 164.

²⁸³ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 84, 97, 102.

²⁸⁴ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 63, 72, 74.

²⁸⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “ndër [...] kishte” në fjalinë e fundit të paragrafit 106 të Aktakuzës së Konfirmuar është aktualisht e redaktuar për Mbrojtjen në zbatim të masave mbrojtëse të miratuara me procedurë gjyqësore. Ky redaktim do të hiqet në kohën e duhur.

(fjalë e dytë), në paragrafin 122 (fjalë e fundit), në paragrafin 123 (fjalë e fundit)²⁸⁶ dhe “në [...] bënin pjesë” dhe “në [...] ishin” në paragrafin 152 (fjalë e dytë dhe e tretë) të Aktakuzës së Konfirmuar, ku, në çdo rast të veçantë, formulimi që vjen pas këtyre frazave ofron më shumë konkretësi lidhur me viktimat e pretenduara të krimeve për të cilat ngrihen akuzat. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përdorimi i frazave të lartpërmendura në këto raste nuk e bën me mangësi paraqitjen e pesë krimeve të pretenduara.

164. Sa i takon lidhjes së të akuzuarve me krimet për të cilat ngrihen akuzat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet arsyetimeve që bën në pjesën IV.F.6. më poshtë.

(ii) Tortura

165. Sa i takon akuzës për torturë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren që në fillim se paragrafi 135 i Aktakuzës së Konfirmuar duhet lexuar së bashku me Listën A dhe me akuzat për burgosje/ndalim arbitrar dhe akte çnjerëzore/trajtim mizor, të parashtruara në paragrafët 59-134.²⁸⁷ Kundrejt këtij konteksti dhe duke mbajtur parasysh konstatimet e bëra gjatë në këtë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se një lexim i tillë ofron konkretësinë e nevojshme në lidhje me kryesit e pretenduar fizikë të veprimeve dhe mosveprimeve të pretenduara që përbëjnë torturë,²⁸⁸ viktimat e pretenduara,²⁸⁹ kohën e përafërt të kryerjes²⁹⁰ dhe vendndodhjen e tyre.²⁹¹

²⁸⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza “ndër [...] kishte” në fjalë e fundit të paragrafit 123 të Aktakuzës së Konfirmuar është aktualisht e redaktuar për Mbrojtjen në zbatim të masave mbrojtëse të miratuara me procedurë gjyqësore. Ky redaktim do të hiqet në kohën e duhur.

²⁸⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 135.

²⁸⁸ *Shih më lart* para. 151.

²⁸⁹ *Shih më lart* para. 152.

²⁹⁰ *Shih më lart* para. 154-155.

²⁹¹ *Shih më lart* para. 153.

166. Sa i takon përdorimit të frazës “ndër të tjera” në fjalinë e parë të paragrafit 135 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se formulimi që vjen pas saj ka për qëllim të ofrojë më shumë konkretësi sa i takon një kategorie të caktuar, pra arsyet për të cilat viktimat pretendohet se janë diskriminuar dhe, për rrjedhojë, kjo nuk i jep mundësi ZPS-së t’i zgjerojë pretendimet faktike të çështjes së saj në gjykim.

167. Sa i takon lidhjes së të akuzuarve me krimet për të cilat ngrihen akuzat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet arsyetimeve të tij në pjesën IV.F.6. më poshtë.

5. Zhdukja me forcë

(a) Parashtrimet

168. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se elementet e zhdukjes me forcë, që përshkruan Gjykatësi i Procedurës Paraprake në Vendimin e Konfirmimit, sugjerojnë se duhet të ketë një lidhje midis heqjes së lirisë dhe mosdhënies së informacioneve më pas, ndërsa Aktakuza e Konfirmuar nuk e paraqet këtë element material të veprës penale.²⁹² Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Krasniqit argumentojnë se përdorimi i frazës “ndër [...] përfshihen” për të krijuar një paraqitje joshteruese të zhdukjeve me forcë, është palejueshmërisht e mjegullt.²⁹³ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashton se është e paqartë se cili ishte roli i z. Thaçi në zhdukjet e pretenduara.²⁹⁴

²⁹² Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 52-55.

²⁹³ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 60; Mocioni Paraprak i Krasniqit, para. 56.

²⁹⁴ Mocioni Paraprak i Thaçit, para. 60.

169. ZPS-ja përgjigjet se, në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes, synimi kriminal i nevojshëm është paraqitur në mënyrë adekuate, përfshirë faktet prej të cilave mund të deduktohet.²⁹⁵

(b) Konstatim

170. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren që në fillim se paragrafi 171 i Aktakuzës së Konfirmuar duhet lexuar së bashku me Listat A dhe C dhe me disa paragrafë të caktuar që kanë të bëjnë me akuzën për vrasje të paligjshme.²⁹⁶ Në veçanti, paragrafi 171 i Aktakuzës së Konfirmuar u referohet paragrafëve 137, 139, 142, 147, 149, 150, 152, 157 dhe 163, që kanë të bëjnë me akuzën për vrasje të paligjshme, që, nga ana e tyre, duhen lexuar së bashku me Listat A dhe B dhe me akuzat për akte të tjera çnjerëzore/trajtim mizor dhe për burgosje/ndalim arbitrar.²⁹⁷

171. Sa i takon përdorimit të frazave “duke përfshirë edhe” dhe “ndër [...] përfshihen” në fjalinë e parë dhe të fundit të paragrafit 171 të Aktakuzës së Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se një përdorim i tillë mund t’i linte vërtet hapësirë ZPS-së të sillte në gjykim prova për raste të tjera shtesë të pretenduara të zhdukjes me forcë, veç atyre që janë paraqitur shprehimisht në Aktakuzë. Në këto rrethana, për të ndrequr çdo dykuptimshmëri të ardhur nga kjo dhe për të sqaruar se rastet për të cilat ngrihet akuza për zhdukje me forcë janë vetëm ato që janë paraqitur shprehimisht në Aktakuzë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të dorëzojë një version të korigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar ku: (i) të heqë frazat “duke përfshirë edhe” (përpara fjalëve “në zona”) dhe “duke përfshirë edhe ato” (pas fjalëve “në qendrat e ndalimit ose në

²⁹⁵ Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 41, ku i referohet ndër të tjera Aktakuzës së Konfirmuar, para. 56, 137, 139, 142, 147, 149-150, 152, 157, 163, 171.

²⁹⁶ Aktakuza e Konfirmuar, para. 171.

²⁹⁷ *Shih më lart* para. 150.

lidhje me to”) në fjalinë e parë të paragrafit 171 të Aktakuzës së Konfirmuar; dhe (ii) ta zëvendësojë frazën “Ndër incidentet [] përfshihen” me frazën “Incidentet [...] janë” në fjalinë e fundit të paragrafit 171 të Aktakuzës së Konfirmuar.

172. Sa i takon kriterit të synimit kriminal për zhdukjen me forcë, në veçanti kriterit të dijenisë se mosdhënies së informacioneve lidhur me fatin ose vendndodhjen e personit në fjalë i paraprante ose i lidhej heqja e lirisë së një personi të tillë,²⁹⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse ashtu sikurse edhe në rastin e krimeve të tjera për të cilat ngrihen akuzat,²⁹⁹ gjendja mendore e veçantë në vetvete nuk është paraqitur dhe nuk ka nevojë të paraqitet shprehimisht në Aktakuzë, Aktakuza e Konfirmuar i përmban faktet provuese prej të cilave mund të deduktohet kjo gjendje mendore.³⁰⁰ Çështja nëse këto fakte janë ose jo të mjaftueshme për të deduktuar gjendjen e kërkuar mendore është një çështje e cila mbetet për t’u diskutuar në gjykim.

173. Sa i takon lidhjes së të akuzuarve me krimet për të cilat ngrihen akuzat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet arsyetimeve që bën në pjesën IV.F.6. më poshtë.

²⁹⁸ Vendimi i Konfirmimit, para. 77.

²⁹⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren, për shembull, se në lidhje me burgosjen/ndalimin arbitrar, fakti se kryesit synonin t’ua hiqnin lirinë fizike viktimave të pretenduara ose vepronin me dijeni të arsyeshme se veprimet ose mosveprimet e tyre kishin gjasë të shkaktonin heqjen arbitrarë të lirisë fizike të personit (Vendimi i Konfirmimit, para. 61) nuk është paraqitur shprehimisht në Aktakuzë, por duhet deduktuar nga faktet përkatëse provuese të dhëna në paragrafët 59-93 të Aktakuzës së Konfirmuar.

³⁰⁰ Për shembull, Aktakuza e Konfirmuar, para. 38 (ku thuhet se krimet e pretenduara dihehin dhe raportoheshin gjerësisht dhe se bënë që në një numër rastesh anëtarë të familjes, individë dhe organizata ndërkombëtare, ose persona të tjerë, të ndërhyjnë për të marrë vesh vendndodhjen e viktimave dhe/ose për të siguruar lirinë e tyre), 96 dhe 171 (ku thuhet se disa raste të përmendura të zhdukjes me forcë pretendohet se janë kryer në qendrat e ndalimit ose në lidhje me to dhe se ishin të shpeshta rastet kur nuk jepeshin informacione lidhur me personat e ndaluar).

6. Lidhja e të akuzuarve me krimet për të cilat ngrihen akuzat

174. Sa i takon lidhjes së pretenduar të të akuzuarve me krimet për të cilat ngrihen akuzat dhe rolit që pretendohet se kanë luajtur në këto krime, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se të akuzuarit pretendohet se mbajnë përgjegjësi për krimet për të cilat ngrihen akuzat: (i) me anë të pjesëmarrjes së tyre në një NKP dhe/ose si ndihmues dhe inkurajues;³⁰¹ dhe/ose (ii) si eprorë për krimet e kryera nga vartësit e tyre.³⁰² Asnjëra prej formave të lartpërmendura të përgjegjësisë nuk përmban një element që të kërkojë që të akuzuarit të kenë luajtur një rol të drejtpërdrejtë në kryerjen e krimeve për të cilat ngrihen akuzat. Në vend të kësaj, lidhja e të akuzuarve me krimet për të cilat ngrihen akuzat duhet të vërtetohet nëpërmjet: (i) kontributit të tyre për qëllimin e përbashkët që përbën ose përfshin kryerjen e një krimi të parashikuar në Ligj (NKP);³⁰³ (ii) ndihmës, inkurajimit ose mbështetjes morale nga ana e tyre për kryerjen e një krimi ku kjo mbështetje ka një ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimin (ndihma dhe inkurajimi);³⁰⁴ dhe/ose (iii) mosmarrja nga ana e tyre e masave të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e krimeve të vartësve të tyre *de jure* ose *de facto*, ose për ndëshkimin e kryesve të krimeve të kryera nga këta vartës (përgjegjësia eprorë).³⁰⁵

175. Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është e nevojshme që në Aktakuzën e Konfirmuar të paraqiten më tej hollësi të tjera shtesë sa i takon lidhjes së pretenduar të të akuzuarve me krimet për të cilat ngrihen akuzat dhe rolit që pretendohet se kanë luajtur në këto krime.

³⁰¹ Aktakuza e Konfirmuar, para. 32-52, 172-173.

³⁰² Aktakuza e Konfirmuar, para. 53-55, 172-173.

³⁰³ Vendimi i Konfirmimit, para. 106-110.

³⁰⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 116.

³⁰⁵ Aktakuza e Konfirmuar, para. 118-121.

G. PËRFUNDIM

176. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, për të siguruar nivelin e kërkuar të konkretësisë dhe të qartësisë dhe për të siguruar që ZPS-ja të mos mund ta zgjerojë më tej çështjen e saj në gjykim, në Aktakuzën e Konfirmuar duhen bërë ndryshimet e përcaktuara në paragrafët 80, 92, 95, 143, 160 dhe 171 më lart. Gjithashtu, siç vërehet në paragrafët 101 dhe 106 më lart, sa herë që pretendohen lloje të ndryshme sjelljeje/formash kontributi kundër disa të akuzuarve njëkohësisht, nëse këto sjellje/këto forma kontributi nuk vlejné për të gjithë ata, ZPS-ja duhet të ofrojë më shumë konkretësi se cila sjellje/formë kontributi ka të bëjë me cilin të akuzuar. Mbështetur në këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të dorëzojë brenda ditës së premtë, datë 3 shtator 2021, një version të korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar, sipas udhëzimeve të dhëna në paragrafët 80, 92, 95, 143, 160 dhe 171 më lart.

177. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton më tej se, duke pasur parasysh: (i) strukturën e Aktakuzës së Konfirmuar; (ii) informacionet konkrete dhe të hollësishme të dhëna, aq sa është e mundur; (iii) natyrën dhe rrethanat e çështjes dhe shkallën e krimeve për të cilat ngrihen akuzat; dhe (iv) faktin se të akuzuarit nuk akuzohen t'i kenë kryer vetë fizikisht krimet, me ndryshimet e lartpërmendura, Aktakuza e Konfirmuar paraqet me qartësi dhe konkretësi të mjaftueshme faktet mbi të cilat mbështeten akuzat dhe krimet, përfshirë format e përgjegjësisë për të cilat ngrihen akuzat. Pjesa tjetër e kundërshtimeve të Mbrojtjes ndaj formës së Aktakuzës së Konfirmuar hidhet poshtë.

H. ZGJATJA E AFATIT PËR LEJEN PËR APELIM

178. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në pajtim me rregullën 77(1) të Rregullores, kur një palë kërkon të apelojë vendimin e një paneli që nuk është i apelueshëm, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim të ndërmjetëm

panelit që ka nxjerrë vendimin e kontestuar, brenda 7 (shtatë) ditësh prej daljes së vendimit. Duke mbajtur parasysh pushimin e ardhshëm veror të gjykatës,³⁰⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se është e përshtatshme të ndryshohet, në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, afati për kërkimin e lejes për të apeluar këtë vendim. Mbështetur në këtë, palët mund të bëjnë një kërkesë të tillë jo më vonë se dita e premte, datë 27 gusht 2021. Çdo përgjigje dhe kundërpërgjigje përkatëse duhet të respektojë afatet kohore të vendosura në rregullën 76 të Rregullores.

V. VENDIM

179. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON, PJESËRISHT**, Mocionin paraprak të Thaçit;
- b. **MIRATON, PJESËRISHT**, Mocionin paraprak të Selimit;
- c. **MIRATON, PJESËRISHT**, Mocionin paraprak të Krasniqit;
- d. **URDHËRON ZPS-në** të parashtrojë për protokollim, brenda të **premtes, datë 3 shtator 2021**, një version të korrigjuar të Aktakuzës së Konfirmuar, sipas udhëzimeve që jepen në paragrafët 80, 92, 95, 101, 106, 143, 160 dhe 171, më lart; dhe
- e. **RRËZON** pjesën e mbetur të Mocionit Paraprak të Thaçit, Mocionit Paraprak të Selimit dhe Mocionit Paraprak të Krasniqit;
- f. **RRËZON** në tërësi Mocionin Paraprak të Veselit; dhe
- g. **NDRYSHON** afatin për çdo kërkesë të mundshme për leje për apelim të këtij vendimi dhe **URDHËRON** që çdo kërkesë e tillë të parashtrohet për protokollim jo më vonë se dita e **premtes, datë 27 gusht 2021**.

³⁰⁶ Pushimi veror i gjykatës është nga dita e hënë, 26 korrik 2021, deri ditën e premte, 13 gusht 2021, *shih* KSCPR-2020, Kryetarja, *Periudhat e Pushimit të Gjykatës për Vitin 2021*, 10 nëntor 2020, publik.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 22 korrik 2021
Hagë, Holandë.